

HEJZA

Besnik MUSTAJ

Fryma e europianizimit në kulturën shqiptare u mboll qysh në Mesjetë dhe është doemos e lidhur me veprën madhore historike të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, i cili e përcaktoi, pakthyesëm identitetin e shqiptarëve si europianë

KULTURA DHE MILITANTËT PARTIAKË TË DEKULTURUAR



Avni HALIMI

Këto ditë u publikua Programi Vjetor i Ministrisë për Kulturë e RMV-së! Përshtypjet e para flasin për një program katastrofal. Vit për vit ka reagime, pakënaqësi, ndërsa për këtë vit, kritikët, profesionistët, thonë se nuk ia vlen të merremi më me këtë dukuri, sepse, fatkeqësisht, Programi për Kulturë tashmë është shans për militantët e verbuar partiakë për t'i shfryer frustrimet, për ta dëshmuar "intelektualitetin" e tyre anti-kulturë, për t'u ndjerë edhe ata "vendimmarrës"! Edhe atë ku? Në kulturë, ë!

Ka edhe prej asaj kategorie militantësh partiakë që, në moment të caktuar, për të pasur ndikim në "hartimin" e Programit vjetor për kulturë, tërë vitin, si puthadorë, vrapojnë nga njëra te dora tjetër e funksionarëve dhe administratorëve partiakë; madje ka edhe prej atyre që "intelektualëve" të partisë u shkruajnë edhe libra, sepse partia duhet të ngelë në kuazi-intelektualë që "dijetarët e partisë" të kenë mundësinë e ndikimit në hartimin e Programit për kulturë!

Ç'është e vërteta, paraprakisht, para se të hapet konkursi vjetor për të konkurruar me projekte vetanake apo të institucioneve nacionale, formohen komisione sipas formulës 75% me 25%! Zakonisht, komisionet janë ose prej 5 anëtarëve ose prej 7 anëtarëve, përkatësisht 3 maqedonas e 2 shqiptarë, ose 4 maqedonas e 3 shqiptarë! Nëpër këta komisione nga pala shqiptare zakonisht

delegohen militantë (natyrisht, me përjashtime, sepse ka pasur edhe profesionistë të padiskutueshëm!); delegohen mësues matematike, hoxhallarë, dallkukë; delegohen kryesisht persona që janë të stërngarkuar me urrejtje dhe mezi presin që të jenë në ndonjë pozitë për ta dëmtuar shkrimtarin, artistin, krijuesin, valltarin, këngëtarin, sepse kështu i ka thënë bashkë-partiakë, qoftë kjo edhe tërësisht në dëm të kulturës kombëtare! Në këtë segment, secila parti duhet të kuptojë se është tërësisht antikombëtare!

Po pse veprojnë kështu partitë "kombëtare"? Pa dyshim, programet e tyre partiake janë tërësisht antikulturore, nuk ka qoftë edhe një faqe "strategji" kulturore nëpër programet e tyre. Po, mund të gjesh edhe fjali të tipit "do bëjmë trajnimin e artistëve që kanë profesione deficitare në lëmin e kulturës (etnolog, arkeolog, historian arti, kulturolog, muzeolog, skenograf, kostumograf, dizajn dritash, fonistë, garderobier dhe grim").

Pra, kur partia e shkruan këtë fjali në programin e vet, kjo do të thotë se ka në plan që "artistët" militantët t'i trajnojë dhe ta eliminojë deficitin prej etnologëve, arkeologëve, muzeologëve, kulturologëve etj. të cilët, në botën e civilizuar dalin si kuadër pasi të kenë studiuar e specializuar me vite.

Ky lloj kulturologësh të trajnuar pastaj caktohen për anëtarë komisionesh që vendosin për Programin vjetor për kulturë, të cilët, në jetë të vetë nuk kanë lexuar ndonjë libër, nuk kanë lexuar ndonjë literaturë profesionale, nuk kanë marrë pjesë në seminare, në konferenca në manifestime të ndryshme ku ligjërohet, debatohet e konkludohet mbi rrjedhat bashkëkohore kulturore.

Ky Program vjetor i Ministrisë së Kulturës nuk është aq problematik për maqedonasit. Ata mund të reagojnë vetëm nga pozita opozitare sa për ta nxirë çdo strategji nacionale e për ta "devaluuar" politikisht pushtetin. Ky Program është problematik dhe jashtëzakonisht antikombëtar, sidomos për shqiptarët e Maqedonisë së RMV-së. Sepse, maqedonasit tashmë i kanë rreth 60 institucione nacionale, mbi 20 institucione lokale dhe mbi 100 ansamble kulturo-artistike. Këta institucione e asociacione kanë strategjinë e vet, kanë programe vjetore, kanë plane zhvillimore e buxhet të planifikuar. Kanë dhjetëra festivale për të cilat, sivjet, nga buxheti i Ministrisë për Kulturë, ndahen rreth 5 milionë euro, pa e dridhur qerpikun se për festivale etnike maqedonase dëmtohet kultura shqiptare.

Programi Vjetor për Kulturë pranë kësaj Ministrie ka kuptim vetëm kur shteti ia del që të sigurojë 25 për qind të institucioneve nacionale, po kaq për qind institucione lokale, si dhe nga 25 për qind ansamble e manifestime të jenë shqiptare.

Çka ndodhë dhe pse ky program vjetor për kulturë? Meqë funksionojnë dhjetëra institucione nacionale, lokale, ansamble e festivale, atëherë shteti obligohet që të sigurojë qindra miliona euro për t'i mirëmbajtur, për rroga, për të qenë sa më funksional dhe sa më në trend me kohën! Duhet të ekzistojë edhe një program për aktivitete kulturore të bashkësive etnike, në të cilën, hisedarë më të mëdhenj prapë na dalin maqedonasit!

Kësisoj, shqiptarët nuk ia dalin të sigurojnë buxhet për kulturën shqiptare as dy për qind nga buxheti i përgjithshëm që shkon për Kulturë në RMV! Dhe, për këtë dy për qind duhet të vendosin militantët partiakë të dekulturuar. Shumica prej militantëve partiakë arrijnë të regjistrujnë asociacione e ojq që dëshirojnë të merren me "kulturë" dhe, anëtarët (militantët partiakë) të komisioneve kulturore buxhetin e ndajnë nëpër këto ojq e subjekte të diskutueshëm, ndërsa nuk llogarisin fare se me këtë sjellje të tyre diletanteske po e thyejnë në kurriz artin, letërsinë, kulturën shqiptare.

Reflekse

KRITERI I NJË ARTI TË RI KOMUNIKIMI

Epoka postmoderne kërkon kriteret e veta të qasjes dhe të qeverisjes kulturore shoqërore. Nëse tanimë postmodernja e ka rrjedhën e saj nga modernia, e cila vjen "pas" (post) dhe me "modernen" së bashku, atëherë duhet të dimë realisht se çka kërkojmë

Remzi SALIHU


Njeriu nuk mëson kurrë prej gabimeve të veta, sepse ato defekte, të meta, personale i injoron para të tjerëve, apo i arsyeton sipas dëshirës së vet. Çdo individ gjatë të veprimtut të tij kreativ bën gabime pa dashje dhe pa i vërejtur ato dhe e keqja më e madhe e këtyre gabimeve të bëra, është kur ato i përsëriten gjatë tërë jetës. Përsëritja e gabimeve e vë individin dhe shoqërinë në një fatalizëm të rëndë e të pa riparueshëm jetësor. Për t'ju shmangur këtij përcaktimi humbës dhe shkatërrues, që i sjell

dëm të madh vetes dhe të tjerëve, duhet të kërkohej nevoja dijes dhe mençurisë që në mënyrë eksplicite të gjykohen drejtë pasojat e tyre. Por, ne kureshtarët, gjithnjë mençurinë individuale do ta kishim plotësuar dhe përm-bushur si duhet, vetëm atëherë kur vëmendjen dhe maturinë do ta kishim orientuar pozitivisht kah vlerat e mirëfillta. Kjo normë është e mundshme kur të jetë individ i në vete autokritik gjatë vëzhgimit dhe ndryshimit të gabimeve të të tjerëve, po qe se ato lëshime të dukshme arrijnë t'i vërejë dhe t'i kuptojë kthjellët nga distanca kohore.

E bukura dhe e shëmtuara

Dihet shumë mirë se njeriu që ka vëmendje të shëndosh nga pësimet edhe mëson, për të mos iu përsëritur të njëjtat gjëra të dëmshme. Por, ka ndodhur shpesh në jetë që gabimet e njëjta të përsëriten dhe stërpërsëriten, ndaj edhe gjërat e vlefshme që preken me këtë fat të pa dëshiruar të akëcililit, për shoqërinë nuk kanë shkuar në vendin e duhur. Këto reforma personale të përsosjes mund t'i bëjë të pranueshme njeriu po qe se posedon në vete syrin kritik të të vlerësuesit të pa anshëm dhe

të pa varur shoqëror. Ndaj çdo individ ka fiksonin e vet të imagjinatës për t'i përfytyruar ndodhitë e shumta në mënyrë artistike, sidomos ato ndodhi e fenomene tipike, të cilat me frymën e tyre ndikuese në shoqëri, janë të inkarnuara nëpër motive të shumta jetësore në hapësirë e kohë. Gjërat e vërteta dhe të drejta në jetë ndërliqhen gradualisht, duke kultivuar në vete maturi dhe mësim permanent. Kërkimi bindës i këtyre gjërave të domosdoshme do të jetë shembull i mirë për të tjerët, se si nuk duhet trajtuar gjërat që si njohim mirë. Sipas kësaj maturie të eman-



cipuar gjallëria e kujtimeve është në gjendje t'u jap shpirt edhe gjërave të vdekura. Dhe ky standard i dëshiruar jetik, i mbamendjes dhe seriozitetit njerëzor pushtohet lehtë, pa shikuar majtas e djathtas, kryesisht pa lakmuar gjërat që si meriton në jetë. Niveli i harmonisë së vlerave arrihet duke shkruar drejtë përkushtimit shkencor dhe sakrificës personale në hulumtim dhe në qëllimin e detyrueshëm të zgjidhjes së gjërave të pakuptueshme. Sidomos ky ndriçim arrihet duke nxjerrë nga përvoja e vetes fakte të shumta dhe rezultate të kërkuara efektive të fenomeneve, për shoqërinë e kohës, e cila shoqëri gjithësi se posedon në vete kontinuitet dhe standard estetik të kultivuar dijesh e veprash të trashëguara me nivel të lartë. Të besuarit e fakteve mund të jenë mirë, por kontrollimi i tyre dhe veprimeve tona nga kënde të ndryshme vëzhgimi nëpër vite nga më të diturit, është edhe më i mirë, po qese duam të rrugëtojmë shëndetshëm dhe me vëmendje të ngritur hulumtuese, e cili hulumtim serioz, në suaza më të avancuara standardi e dijesh, do të na ndihmojë në jetë dhe në shkencë. Këtë përvojë dallueshmërie e ka secili në një far mënyre të instaluar e farkuar në vete, si vlerë dalluese, apo si argument bazë i përvojave të përjetuara nga të tjerët dhe vetja. Këto nivele krahasuese me kriter, gjenden të bartura sistematikisht gjatë tërë jetës sonë. Në vlerësojmë të tjerët, ata na vlerësojnë neve dhe kështu shkohet përpara në jetë, për të sjellë risi dhe vlera të mirëfillta shoqërore. Me këtë formë e zhvillim kulturor, tërësor në shoqëri, jeta merr dimensionin dhe drejtimin e duhur antropologjik. Kështu njeriu gjen rrugëdaljen e tij nga barrierat e dala të vështirësive dhe kërkesave shoqërore të imponuara papritmas. Prandaj nga ky konglomerat i ngjarjeve të shumta kulturore që kemi tani, tipikja ngandonjëherë na duket si atipike dhe atipikja na shëmbëllen si tipike e veçantë gjatë të vlerësuarit të fenomeneve. E bukura dhe e shëmtuara janë dy pasqyra që tërheqin vëzhgimin tonë. Këto dukuri kundërshtuese, estetike, na e tërheqin vëmendjen gjatë tërë jetës dhe zhvillojnë në ne shijen efikase të emancipimit kulturor, për t'i kuptuar dallueshmëritë më elementare të tyre. Ndaj tani mund të themi se procesi zhvillimor i shoqërisë sonë varet nga ne se jemi të ngritur dhe të ditur në profesione të veçanta, dhe posaçërisht sa jemi të armatosur me këtë art dhe kulturë të vazhdueshme shoqërore, për t'i ndryshuar gjërat në ne dhe për rreth nesh.

Shtegu i rrugëdaljes alternative

Sot, nga rrethanat dhe standardi i brishtë që kemi amputuar në trup, nëse nuk ndryshohet gjendja e tanishme politike e kulturore në rrethin tonë, do të jetë edhe më rëndë për të krijuar sistem të shëndosh arti dhe sidomos nivel ekonomik të kënaqshëm, për plotësimin e mirëqenies kulturore, qytetare dhe perspektivë të shëndetshme pasardhëse. Sepse situata e turbullt që vepron në mënyrë subversive në shoqëri, do të na ndëshkojë dhe kushtoj shtrenjtë neve, kurse nga gabimet dhe gjendja e instaluar e formalitetit të vrazhdë politik, të njëanshëm, do të merremi gjatë me pasojat e pa

shërueshme. Dhe kriza e përgjithshme do të zgjatë edhe më shumë në mjediset tona. Prandaj, sot, marrëdhëniet politike dhe kulturore nga pësimet duhet të na mësojnë se si të shkohet përpara, si t'i vëmë kriteret e duhura ligjore, për veten dhe të tjerët. Nuk duhet t'i pranojmë gjërat që bëhen shkel e shko në jetën publike. Nuk duhet të pranojmë detyra e poste që nuk ua gjejmë dot zgjidhjen. Pastaj nuk duhet të derdhim shpejtë e shpejtë zhavorrmin e ngjyrave mediokre, për mbi ne dhe t'i vëmë alternativës shoqërore barriera kufizimesh e tendencash përrnbyse, që stimulohen nga klanet e së keqes, sidomos për përfitim të shpejtë, që pastaj ne ta përkundim veten ngathtas në iluzione të rënda dhe të pa kuptueshme. Apo të kalarohemi rrejshëm nëpër struktura të mbyllura interesash politike parciais e fisnore, kurse nga mos dija mund edhe ta burgosim shtegun e shpresës optimiste të pasardhëseve tanë të mençur. Çdo gjë nga formaliteti i prurjeve të dobëta merr tatëpjetën, dhe posaçërisht kjo është e dukshme kur para vetes vëmë inatin dhe interesin tonë më të keq, të ndërtuar në çdo mënyrë të veprimit intolerant nëpër tranzicionin e stërzgatur me dekada, mu nëpër këtë thellësinë e përrnbytur të ekzistencës së rënduar në sistem. Ndaj, si majtas si djathtas, duhet të zhvillohet potenciali i vlerave të mirëfillta dhe të bëhet standardi i kulturës së përzgjedhur efektive. Më të mirët dhe më të suksesshmit le të na e tregojnë shtegun e rrugëdaljes alternative. Sepse mbyllja në vete dhe derdhja e klisheut fjalomani neveritëse në ne, nuk na përgatit mirë, me muskuj mendimesh të forta e alternative.

E mira e të mirave është të bëhet dizajnimin i ri shoqëror dhe të shpalohej në shoqëri rendi emancipues sa më i fuqishëm, për perspektivë të ndritur kulturore, posaçërisht, për t'i ndihmuar sa më shpejtë dhe me devotshmëri integrimin gjithë shqiptar. Kjo praktikë përparimtare atëherë do të shërbente kauzës kombëtare vetëm me nivel dijesh elitare, për të ardhmen tonë të shëndosh, e cila dije pastaj nga paradigma e shembullit të mirë në kohë, do t'i jap kësaj shoqërie suksese, hapësirë dhe kahe ndriçimi të kualifikuar për të shkruar përpara me dinjitet e me ndershmëri. Dhe gjithësi se kjo përgjegjësi individuale dhe kolektive do të shërbente në të ardhmen për të hapur shtigje të mundshme standardizuese për të gjithë ata që preferojnë një zgjidhje globale efektive, afatgjate kombëtare.

Sot gjendja politike e shoqërisë sonë është rënduar keq e më keq nëpër tërë trupin shqiptar. Vepron mbrapsht në kulturë, shkencë dhe ekonomi. Këtu te ne në Ballkan jemi popull i veçantë, që kemi mbetur të fundit për integrim përgjithshëm. Fajësojmë njëri tjetrin, hyjmë e dalim nëpër çadra e partish interesash personale. Bllokojmë rrugë e mendime alternative. Përsëritim me të njëjtën formë të sabotimit dhe të ideve. Nuk e duam ligjin. Bllokojmë vetingun dhe drejtësinë e mirëfilltë. Djegim vendin për interesa personale dhe nuk trishtohemi për të shëmtuarën tonë të përgjithshme, por të gjithë ne nga kjo krahurë përrnbyse, më në fund jemi të ngulur në fenomen të keq utopik. Nuk mund të mbetet shoqëria tërë jetën në tranzicion. Dikush i ka fajet për gjendjen e krijuar, por tani fajin më të madh e kanë ata individë që

mbanë poste dhe detyra që ua ka besuar shoqëria. Bile disa janë aq grabitqarë sa që takatin e tyre të brishtë të marrjes dhe dhënies së energjisë së tyre, e ngarkojnë pa vetëdije me mbi peshë të rëndë pa përgjegjësi. Nuk u vjen turp se bëhen improvizues të gërditshëm, mu në rrethin ku veprojnë e infektjnë për të keq. Bëhen lakmuarë të papërmirësueshëm nëpër të gjitha segmentet dhe sferat e jetës sistimore. Uzurpojnë vend e pa vend të mirat e kësaj shoqërie të lënduar me vite. Tani koha kërkon risi dhe ndryshime permanente. Prioritetin e kësaj vetëdije zhvilluese, duhet të ketë standardi shoqëror efektiv dhe me afat të caktuar të arrihen gjërat që si posedojmë. Nga ky realitet i shëmtuar që kemi tani te ne, apo te shtetet tjera post komuniste, nuk mund të pritë në pakufi kohe standardizimi i vetes. Të gjitha këto shtete të dala nga komunizmi, duhet t'i japin llogari dhe afat të caktuar ndryshimit ekonomik dhe kulturor të tyre.

Fabrika kulturore "Rilindja"

Epoka postmoderne kërkon kriteret e veta të qasjes dhe të qeverisjes kulturore shoqërore. Nëse tanimë postmodernja e ka rrjedhën e saj nga modernja, e cila vjen "pas" (post) dhe me "modernen" së bashku, atëherë duhet të dimë realisht se çka kërkojmë, në të vërtetë, në funksionimin e drejtë të kësaj epoke të re. Si të shërbehemi me këtë standard të imponuar të kohës? Nëse kjo epokë në funksionimin e saj të mirëfilltë përfshin vitet e nëntëdhjeta (90), por ne duhet patjetër të dimë ta nuhatim nga e kaluara shkencërisht këtë epokë të ardhur edhe në mesin tonë. Rrënjët e saja duhet t'i kërkojmë më herët qysh nga vitet tetëdhjeta (80) edhe pse kjo frymë hetohet te disa krijues edhe më herët. Nga kjo na del bindja e evidente se rinia e atëhershme i theu me vullnet të madh dhe sakrificë këto pengesa barrierash, kufizuese sistemesh të kësaj ane. Ajo rini atëherë filloi të kërkojë të njëjtin standard jetese dhe kulture si te popujt tjerë evropian. Këto ngjarje nuk duhet të harrohen dhe anashkalohen. Në atë kohë, ne me teknologji dhe industri edhe pse nuk ishim të përafërt me shtetet e zhvilluara industriale, por në atë pjesë esenciale të kulturës ekzistonin elemente të përafërta ndikimi dhe importimi vlerash të shumta standardizuese. Më kujtohet, në ato vite entuziazmuere të kthesave të metodave artistike, të epokës së re, kur fabrika kulturore e atëhershme "Rilindja" i përcillte kujdeshëm këto rrjedha e trende botërore moderne dhe postmoderne. Bënte të pa mundur në vete që të jetë një hap me kohën dhe vlerat që kultivoheshin te popuj tjerë përparimtar. Gjurmët e këtyre drejtimeve hetoheshin te disa lëmi arti dhe sidomos te disa autorë të veçantë të kohës. Të themi se në letërsi, Anton Pashku (1937-1995) Azem Shkreli (1938-1997), Rrahman Dedaj (1939-2005), Ali Podrimja (1942-2011), Teki Dervishi (1943-2011), Ibrahim Rugova (1944-2006), Beqir Musliu (1945-1996) etj, që tani nuk janë midis nesh, deri në vitet tetëdhjeta përfaqësonin grupin e poetëve dhe studiuesve modern, kurse pas këtyre viteve Rilindja, nga këta iniciues dhe stimulues, përzgjedhi grupin e epokës më të re, të "Plejades" alarmuese, si një kthesë nisimtare tjetër kohore. Ata teknikisht dhe artistikisht kanë qenë të sofistikuar nëpër veprat e tyre me në një trend të ri shkriam postmodern. Këta pjesëmarrës aktiv ishin dhe janë autorë të veçantë shqiptar, që jetonin nëpër të gjitha viset e ish Jugosllavisë. Shkrimet e tyre sollën një frymë të re qasjeje dhe komunikimi të standardizuar, sidomos në art e kulturë. Ata i vunë bazat e një arti të ri post modern në letërsinë e asaj kohe. Patjetër duhet të themi edhe këtë veçanti jetese të atëhershme kulturore, se këtë kohë të "vrullshme" e të ndritur të epokës së re, e përfshinin dhe nxisnin një sërë faktorësh botëror, posaçërisht dalloheshin dhe jepeshin shembuj bazë të ndikimeve e të ariturave të shumta shoqërore perëndimore. Kultura e atëhershme bënte përpjekje maksimale në integrimin e saj për një rend të ri kulturor botëror, e cila më në fund do të shpalojë fuqishëm veten gjatë globalizimit të saj tipik, dhe sidomos të veprimit ndikues, në vitin 92. Në këtë kohë u formuan dhe u zhvilluan shumë institucione e asociacione kulturore private që kishin ndikim permanent në zhvillimin shoqëror të qytetarit. Teknika,

media, kultura, filluan të marrin një trajtim tjetër zhvillimor. Filluan të privatizohen gjërat. Individualizmi fillon të marr kahen e vet. Shumë autorë dhe shkencëtar të mirëfilltë bënë një prurje idesh heterogjene, e të shumanshme. Shoqëria tradicionale fillon ta zbeh qëndrimin e vet snobist e ndikues te të rinjtë, e cila po nga ai brez, filloi me të madhe të përkrah individualizmin, filloi të bëhej pengesë kulturore shterpëzimi i artit të realizmit socialist. Përkraheshin stile dhe alternativa shkrimesh jo konvencionale, etj. Kjo shihej nëpër të gjitha segmentet e jetës dhe artet e kohës. Nga e kaluara merrej vetëm ajo që ishte art i mirëfilltë. U botuan vepra me nivel të lartë krijimi, që sot e kësaj dite shpalohej si vepra me nivel të lartë dhe të arrira artistikisht. Nuk përfilllej dogmatizmi i realizmit socialist. Konsumoheshin trendë dhe metoda të reja shkrimore që afronte bota e civilizuar.

Liria elektronike

Letërsia këndej kufirit armë kontrollohej dhe censurohej nga profesionist të vërtetë. U krijua një standard vlerash avancuese. Para vite nëntëdhjeta ndryshe ishte në Shqipëri. Arti dhe letërsia ishte e detyruar të mos dal nga kornizat dogmatike ideologjike në edukimin permanent të shoqërisë. Nga kjo letërsia e shtetit armë kishte edhe autorë e studiues që e preferonin vazhdimësinë e një letërsie që dilte nga qendra, por një "kajmak letrar" i tillë nuk ishte aq dominues. Ajo periudhë u tejkalua shpejtë nga rrethanat e kohës, sepse këndej kufirit nga bota perëndimore hynin metoda dhe shkolla letrare që dirigjorin përmasën letrare moderne dhe post moderne të atyre viteve. Këto ndikime atëherë ishin evidente dhe alarmonin efekte ndikuese standardizuese në shoqëri.

Edhe pse përherë kanë ekzistuar bazat e një komunikimi të ri, vështirësitë përherë kanë qenë të pranishme. Ngandonjëherë edhe nga liria e shprehjes së pakontrolluar burgosen vlera të mirëfillta. Kështu pas kësaj kohe në treg mediatik filluan dalin edhe një mori librash të censuruara dhe të redaktuara shkel e shko. Nëpër ato libra private ekzistonin redaktime edhe me emra të njohur shkrimtarësh e kritikësh, që nuk e dinin edhe vet si mund ishin të pranishëm nëpër ato vlerësime të brishta. Kujt t'i tekej botonte çka të dojë. Shkollimi mori tatëpjetën. Mësohej nëpër podrumë. Diplomant merreshin nëpër lokale e kthina të ndryshme. Magjistratura dhe doktoraturat e humbën vlerën e vet shkencore. Pas viteve të 2000 e këndej vërshoi përrnbytja e madhe kulturore. "Profesorët" filluan edhe kolumnet e tyre gazetareske t'i quajnë shkencë. Emil Staigeri (që kishte për zemrë autorët klasik, Homerin, Sofokliun, Virgjinin, Danten, Cornellin, Racinin, Gëten, Shilerin, Petrarqën, Rilken etj.) në librin e tij të njohur Die Kunst der Interpretation, 1955, Mjeshtëria e interpretimit përktim R.S. (ka dhënë shumë mendime bindëse për interpretimin dhe tani po parafrazon një mendim të tij, për të plotësuar këtë shkrim, kur thoshte se "ai që merrej me letërsi dhe gazetari, e humb o njërin o tjetrin, ose që të dyja".

Këto lëshime te ne erdhën nga pamundësia e sisternimit profesionist të individëve në vendet udhëheqëse kulturore e artistike. Sot jemi të përrnbytur nga ky formalitet improvizues në kulturë dhe sidomos në letërsi. Kjo pakujdesi e ka bërë letërsinë "mishmash" dhe dashamirët e artit, gjegjësisht profesionistët, të mos marrin pozicionin dhe autoritetin e duhur në shoqëri. Anashkalohen dhe përdhunohen sistematikisht vlerat e mirëfillta nga hipertensionin i veprave të shumta të dala pa kriter e dije të verifikuar. Ato improvizime veprash janë bërë sot shumicë dhe kanë ndikim permanent të keq, në edukimin e mbrapshtë të shoqërisë. Me zhvillimin e teknologjisë kujt t'i teket plasojn ide dhe mendime të pa kultivuar. Nëpër komente të tilla lexon sharje dhe kundërshtitja pa një përgjegjësi personale. Autorë të mëdhenj bëhen të vegjël dhe të vegjlit bëhen të mëdhenj, duke u kritikuar e radhitur pa fije kriteri e niveli nga individ të ndryshëm. Liria elektronike ua ka mundësuar të gjithëve ta shohin veten në pasqyrë kohe. Vlerat dhe jo vlerat mund t'i hasim për çdo ditë nëpër këto ekrane e portale elektronike të mundshme aplikative...

Për frymëzimin, procesin krijues, kohën...

LIRIA ME GERMË TË MADHE

Nehas SOPAJ

Pak mund të flas për atë që lidhet me çështjen e ndonjë botimi të ri timin. Ka një kohë të gjatë që jam marrë me ligjëratat (leksionet) studentore, të cilat i kam mbarështruar në një tekst universitar që pritet të botohet sivjet. Në aspektin e krijimtarisë sime letrare, them se pyetja Juaj po më gjen "gafil" si i thonë një farë fjale. Jo sepse duhen shumë shpjegime për një temë kaq konkrete dhe të qartë, por sepse s'di si të them: nëse them se s'po bëj asgjë, atëherë s'po e them të vërtetën, po nëse them se në këtë të vërtetë ka shumë pertubacione dhe turbulenca të miat personale, atëherë kjo është e vërteta e saktë. Po rikrijoj, jo po krijoj. Po bëj diçka të re nga ajo që e kam shkruar dikur; ja, kjo është ajo që po bëj unë sot. Me gjuhën e një fjalori të ri, postmodern, po shkruaj palimpseste (jo në kuptimin bukal të fjalës). Rrallë dhe fare pak, mund të quhen krijime të reja ato që po i shkruaj sot, një farë krijimi i serishëm i temave që i kam punuar, mbaruar dikur. Diçka si trilogjia "Vallja e vdekjes së verdhë", që në fakt është një rishkrim i disa tregimeve dhe novelave të mia të ngritura në tre romane. Kjo është përgjigja ime e drejtpërdrejtë pyetjes Suaj. Për kuriozitetin Tuaj dhe të lexuesve, po them atë që tashmë e kam bërë: poezitë e vëllimet poetik "Algjet", të botuara më 1973, të ribotuara në disa përzgjedhje të miat, po i rimarr, po i rishkruaj, tani të rimuara, po i "gdhend". Ose, prej një krijuesi atipik, hermetik, po i kthehem një "prishjeje" të qëllimshme krijimeve të mia të mëparshme. Ose, po i prishi krejt, diçka po bëj! Këtu nuk e kam fjalën për kontekstin kohor rreth krijimtarisë sime letrare, aspak nuk dëshiroj të flas për të kaluarën e largët, sado që kjo mund të shihet vetëm nëse këto



shkrime të reja botohen nesër. Jo, këtu nuk e kam fjalën për shkrime që nuk kanë qenë të botuara për shkak të mungesës së lirisë, që të thuhet saktë e vërteta si të "Vallja...", por si mund të thuhet ndryshe e vërteta artistike në kontekstin më të ri kohor, të sotëm; këto janë frymëzimet e reja nga poezitë e mia "të vjetra", të cilat po i ripunoj. Poezitë e mia të para kanë qenë "hermetike" (nuk po vetëpeshorohj, kështu kanë thënë të tjerët), tash po i bëj ndryshe. Po "i kthjelli" ose po i prishi. Çështja e lirisë krijuese gjithmonë është terren për spekulime, gjë që me shpirt e urrej, prandaj lufta ime më e madhe është ta luftoj alteregon time të spekuluar, mos të dal çka në fakt nuk jam. Nëse shkrimet e mia mund të jenë të suksesshme (ose të pasuksesshme), janë të këtu sepse janë përjetime të vërteta, jo të spekuluar. Mjerisht, e gjithë letërsia e realizmit socialist ka qenë e këtuillë,

spekulative, mu siç është ajo "liri spekulative", si dje si sot, por edhe përgjithmonë e këtuillë ishte: e pështirë, false, e rrejshme. Për veten time them se nëse dikur, si i ri, kisha dëshirë që shkrimet e mia të botoheshin të këtuilla siç ishin, tash nuk e kam ngenë nëse vonojnë të botohen, madje edhe nëse nuk botohen fare; për asgjë nuk bezdisem, sepse e di se Liria e vërtetë mungon. Liria e vërtetë mungon, gjersa një komb i ndarë dhe i përçarë siç është ky i yni, kaq sa të turpërohes si është, i këtuillë. Më mundon fakti nëse nuk arrij ta krijoj, jo ta imagjinoj Lirinë time. Arsyet janë nga më të ndryshmet pse nuk më ngutet, tema e lirisë krijuese është temë që duhet të kuptohet mirë si duhet të koncipohet në fundamentin saj. Jo, liri absolute s'ka, sepse ajo nuk ekziston, por liri me kuptimin e plotë fjalës, ne shqiptarët nuk e kemi pasur asnjëherë, por nuk e kemi akoma edhe sot, mjeri-

sht! Gjenerata ime, jo e jo. Krijimtaria letrare, faktikisht është luftë e përhershme se si të gjurmohet dhe krijohet ajo Liria me Germë të Madhe, ndërkaq krijuesit më të mëdhenj, gjithë jetës s'bëjnë asgjë tjetër pos që kanë luftuar ta krijojnë atë, Zonjën Liri. Kujtojeni Beqir Musliun, një ndër emrat më të mëdhenj të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Ai duke e gjurmuar lirinë e vet krijuese, faktikisht gjithë jetën e tij ka gjurmuar, ka punuar të duket Ajo, ka eksperimentuar në gjuhën letrare, dhe prandaj themi se ai e ka gjetur eliksirin: gjuha e tij, pos se është e lirë, kumbon dhe lirshëm komunikon me lexuesin, ajo thotë shumë më shumë të vërteta se sa liria në kuptimin klasik të fjalës, ajo vetvetiu është artistike, sepse komunikon me nënshtresat e nëndijes njerëzore, hapur dhe qartë tregon se është e lirë, sepse mund të lexohet dhe kuptohet në të gjitha gjuhët e botës. Po ju citoj: "Ç'liri po ju kërkoni aktualisht frymëzimi e, ç'liri jeni në gjendje t'i siguron ju në këtë kohë ku çdo gjë po bëhet pengesë krijuese, madje edhe vetë koha!" Nuk besoj të jetë pengesë kaq e pakapërcyeshme nëse nuk jemi vigjilentë për veten tonë dhe kohën ku jemi, nëse nuk shohim se gjithmonë ka një sferë tejkalimi të çdo barrikadimi, para së gjithash gjuhësor, pastaj edhe të besimit se, Një Ditë do të Bëhet Mirë. Nëse nuk besojmë në këto fjalë, atëherë s'ka shpresë, s'ka ëndrra, s'ka letërsi të mirë, ka zhgënjime dhe djerrakohësi. Jemi në epokë të re dhe gjithçka po performohet. Nuk besoj në vdekje të magjisë së librit, sado që interneti po na i prish të gjitha imazhet e konceptit kohë/hapësirë. Nëse po ndryshon teknika e gjuhës me "teknizimin" e saj, ne vazhdojmë të jemi prej mishi e gjaku të njëjtë, ne gjithmonë ëndërrojmë që do të thotë se përherë ka një shtegdaljeje.

Ese

TREGU KU SHITET NJERIU

Erich FROM

Këtu, si në çdo treg mallrash, vlera e konsumit është e pamjaftueshme për të përcaktuar vlerën e këmbimit. Faktori "individ", për nga rëndësia e tij, mbizotëron sipas çmimit të tregut, mbi mjeshtërinë profesionale dhe shumë më shpesh luan një rol vendimtar. Megjithatë, personi më joshës nuk mund të kompensojë mungesën e plotë të mjeshtërisë, përdërisa sistemi ynë ekonomik nuk do të mund të funksiononte mbi një bazë të tillë. Është e rrallë kur mjeshtëria dhe ndershmëria në vetvete sigurojnë sukses.

Formula e suksesit shprehet me fjalë të tilla, si aftësia për të shitur veten, zotësia për të dhënë (dhuruar) veten, proces energjie (energjitizim), ambicie, gjallëri, agresivitet etj., të cilat vihen, njëllon si edhe çmimet, në paketimin vetjak të fituesve. Karakteristika të tilla, prejardhja, përkatësia në një klan të caktuar, lidhjet dhe ndikimi, janë mjaft të dëshirueshme dhe do të reklamohen,

ndonëse jo aq hapur, si epërsi themelore të mallit të ofruar. Përkatësia në këtë apo atë fe dhe respektimi i ritualeve të saj shikohet nga shumë vetë si një prej kushteve të domosdoshme të suksesit. Çdo profesion, çdo sferë e veprimtarisë ka një sferë të veçantë të personalitetit (personit) që përdoret me sukses. Tregtarit, bankierit, mjeshtër, kamarierit u paraqiten kërkesa të ndryshme, megjithatë rolet që ata kryejnë kanë dhe diçka të përbashkët, të gjithë ata duhet të plotësojnë një kusht themelor, të kenë kërkesë.

Qëndrimi i njeriut ndaj vetes në mënyrë të pashmangshme përcaktohet nga këto kritere të suksesit. Ndjenja e tij e dinjitetit personal bazohet jo në vlerësimin e aftësive të tij dhe përdorimin në një shoqëri të caktuar. Ajo varet nga fakti se sa përdoret nga kërkesa në treg apo nga mendimi i të tjerëve rreth joshjes së tij. Ai ka të bëjë me veten si mall, i destinuar të gjejë ofertë në kushte sa më të leverdishme,

sipas një çmimi më të shtrenjtë. Sa më i lartë të jetë çmimi i propozuar, aq më shumë theksohet vlera e tij para syve tanë. Njeriu-mall me shpresë demonstron etiketën e tij, duke u përpjekur që të veçohet nga mallrat e paraqitura në tezgë, për t'u parë dhe për të qenë i vlerësuar sipas taksës më të lartë. Por, në rast se atij nuk i vete mbarë dhe e shmangin, atëherë kur atë e blejnë të gjithë, ai nxjerr përfundimin për mospasjen e një vlere të plotë të tij dhe të një mungese të vlerës. Megjithatë, sado që atë ta vlerësonin lart, dhe nga pikëpamja e virtyteve të tij njerëzore, dhe nga pikëpamja e dobishmërisë së tij, ai megjithatë njëllon mund ta ndjej veten një njeri pa fat dhe të pranojë mbi vete fajin e asaj që ka dalë jashtë mode.

Që nga fëmijëria e hershme ai është mësuar të përvetësojë se, që të jesh në modë, do të thotë që të përdoret nga kërkesa dhe se ai, si të gjithë, duhet të kënaqë kërkesën në tregun e personaliteteve. Por virtytet që e mësojnë atë, ambicia, zotësia për t'u orientuar dhe

për t'u përshtatur kërkesave të të tjerëve, janë cilësi tepër të përgjithshme që të sigurojnë arritjen e suksesit. Njeriu i drejtshëm literaturës popullore, gazetave, kinofilmave, që të marrë shembuj më konkretë të arritjes së suksesit dhe që të gjejë shembuj më të bukur, më të rinj të prodhimit të tregut, shembuj që duhet t'i imitojë.

Nuk ka asgjë për t'u çuditur që, në rrethana të tilla, ndjenja e dinjitetit personal të njeriut cenohet fort. Kushtet për vetërespektim gjenden jashtë pushtetit të tij. Ai varet nga vlerësimi i të tjerëve dhe vazhdimisht ka nevojë për këtë. Rezultat i pashmangshëm i kësaj janë ndjenja e pazotësisë dhe e pasigurisë. Orientimi i tregut e privon njeriun nga individualiteti, ai bëhet i tjetërsuar nga vetvetja. Në rast se vlera më e lartë e njeriut është suksesi, në rast se dashuria, e vërteta, drejtësia, dhembshuria, mëshira, nuk i sjellin atij asnjë dobi, ndoshta ai prapë mund t'i predikojë këto ideale, por nuk do të synojë drejt tyre.

TRAJTIMI I INDIFERENTIZMIT NDËRNJERËZOR PËRMES NJË POEZIE

Poezia "Kaftjalli" e Preverit është tërësisht e zhveshur nga rekuizitat figurative dhe aq spontane në rrëfimin e idesë, e strukturuar në një monokolonësh, eventualisht në dy-tri fjalë për çdo varg. Atëherë, çfarë e bën këtë poezi aq tërheqëse, që t'i qasesh në mënyrë të veçantë dhe kreative?

Sadik KRASNIQI

Në mos të parët, shkrimtarët janë krijuesit që, në mënyrë të veçantë, hetojnë, gjegjësisht pasqyrojnë disa fenomene jetësore. Ata, edhe pse me veprat e tyre synojnë artistiken, gjithashtu zbërthejnë fenomene të fushave të ndryshme (filozofike, sociologjike, etike, psikologjike etj.), shpesh më mirë dhe më thellë sesa këto fenomene të zbërtheheshin me anë të mjeteve dhe metodave të tyre përkatëse. Në këtë mënyrë, Shekspiri pasqyron luftën, përkatësisht intrigën për marrjen e pushtetit të "Hamleti"; Balzaku trajton fenomenin e mospërfilljen fëmijë-prindër të "Xha Gorioi"; Orulli trajton fenomenin e tretjes së genies njerëzore si pasojë e mekanizmit ideologjik të supershtetit në romanin "1984"; Elsa Triole i qaset trajtimin të mundësisë së skllavërimit dhe të tjetërsimit të njeriut nga pasioni për pasuri të "Trëndafil me kredi"; Markezi romanin e tij "Kolone-lit s'ka kush t'i shkruajë" e ndërton mbi fenomenin e vetmisë absolute.

Ndërsa një fenomen tjetër të kohës, indiferentizmin ndërnjerëzor, si pasojë e dinamikës së jetës, do ta hetojë, gjegjësisht pasqyrojë, poeti i madh frëng, Zhak Preveri, në një trajtë më të vogël letrare: në poezinë "Kaftjalli".

Është thënë shumë herë, se disa poezive të disa autorëve u kthehesh përherë dhe të bëjnë disi "rob" të riletimit të përhershëm të tyre. Kjo ndodh shpesh nga niveli i tyre i lartë artistik ose ngaqë përmbajnë ndonjë veçanti, që përmbushin shijen artistike të përjetuesit. E tillë (që ia vlen t'i kthehesh përherë) është edhe poezia "Kaftjalli" e Zhak Preverit. Por këtë poezi (si shumë të tjera të këtij autori) nuk e shquan ndonjë figurshmëri e theksuar artistike, ndonjë stil i lartë apo ndonjë strukturë versifikative. Përkundrazi, si e tillë është tërësisht e zhveshur nga rekuizitat figurative dhe aq spontane në rrëfimin e idesë, e strukturuar në një monokolonësh, eventualisht në dy-tri fjalë për çdo varg. Atëherë, çfarë e bën këtë poezi aq tërheqëse, që t'i qasesh në mënyrë të veçantë dhe kreative?

Kjo është një poezi për një fenomen: fenomenin e indiferentizmit ndërnjerëzor në njërën anë, si dhe prirja e poetit që këtë fenomen ta interpretojë aq bindshëm, saqë gjatë leximit kushtëzohet një përjetim i thellë i idesë së poezisë. Poezia fillon në mënyrë të rëndomtë, si nis dita në mëngjes. Andaj që në nisje, atmosfera në këtë poezi është tmerrsisht e njëtrajtshme, monotone, e ftohtë, pa gjak, plot ironi, krejtësisht indiferente, pa intimitet afrie. Në poezi, si në jetë, ai tjetri karshi poetit-njeri, nuk bën asgjë, pos "qiti kafe / në filxhan, / qiti qumësht / në filxhanin e kafesë /, qiti sheqer / në kafe me qumësht".

Edhe pse ai/ajo është në praninë e njeriut (poetit), që ndien njerëzisht, vazhdon tmerrshëm me: lugën e vogël / e përzjeu. E ç'i mbetet atij përballë njeriut, pos që: "piu kafënë me qumësht / dhe la filxhanin...". Çfarë tmerrri, çfarë indiference ndërnjerëzore?!

Në këtë poezi-jetë (rastësisht, domosdoshmërisht) takohen e s'takohen dy veta (janë prezentë vetëm si dy qenie fizike); shihen e s'shihen; ndiejnë e s'ndiejnë asgjë për njëri-tjetrin si qenie humane (por jo edhe si poetë). Ata, edhe pse rrinë afër (vetëm fizikisht), kurrë nuk bëjnë dy e as një të përbashkët, por gjithmonë do të mbeten si një dhe të vetmuar...


E gjithë këtë ekuacion të raportit shpirtëror e bën tjetri në prani të poetit, akëcili qoftë ai, nëk apo i afërt i poetit, gjegjësisht i njeriut, me një indiferencë gati inorganike. Poeti (vetëm duke qenë i tillë) e ndien shpirtërisht këtë situatë, kështu që arrin ta inkuadrojë veten në këtë ftohtësi, me një përjetim shokues, duke lëshuar pasthirmën: "Pa folur me mua". Mu këtu ndodh edhe tragjika, me praninë e poetit si qenie e ndjeshme dhe fisnike përballë një qenieje tjetër universale indiferente. E ai (ajo) prapë me atë ftohtësi:

"Ndezi një cigare / bëri rrathtë / me tymin e saj".

Mbase këto vargje paraqesin (rrathët e tymit) trysni mendimi me dozë arrogance. Madje, të gjitha këto bëhen vetëm hi, se ajo "shkundi hirin / në taketuke", e heroit klithi: "Pa folur me mua / pa më shikuar". Këtë indiferencë ndërnjerëzore padyshim e kushtëzon dinamika e jetës, ku çdo gjë duhet të bëhet shpejt, sepse jeta është shumë komplekse dhe, duke qenë e tillë, njeriu është bërë rob i mekanizmit të saj. Si rezultat i saj, njeriu tjetërsohet, dehumanizohet, humb për afërsinë, intimitetin, bëhet boshllëk ndijmësh dhe, si i tillë, duhet të ketë kohë për çdo gjë, por jo edhe t'i kthehet vetes-njerëzores.

Njeriut, si qenie e programuar dhe e instrumentalizuar nga ingranazhi i jetës, vërehen vetëm veprimet fizike: "U ngrit / vuri / kapelën në kokë / veshi / mantelin e shiut / sepse binte shi / dhe u nis / nëpër shi / pa një fjalë / pa më shikuar"... Një mospërfillje e tillë në poezi dhe në jetë poeti e përjeton rëndë, kështu që idenë e poezisë e përmbyll në një moment dhe akt afër çmendjes, që manifestohet me një klithmë në shenjë proteste të heroit lirik të kësaj poezie: "E unë / Kapa kokë në duar / Dhe qava".

Mendojmë se fenomene të tilla, që pasqyrohen përmes veprave letrare, nuk janë studiuar sa duhet dhe, si të tilla, janë problematika të hapura për kritikë, por me një qasje më tepër se vetëm letrare.



KAFTJALLI*

Qiti kafe
Në filxhan
Qiti qumësht
Në filxhanin e kafesë
Qiti sheqer
Në kafe me qumësht
Me lugën e vogël
E përzjeu
Piu kafënë me qumësht
Dhe e la filxhanin
Pa folur me mua
Ndezi
Një cigare
Bëri rrathtë
Me tymin e saj
Shkundi hirin
Në taketuke
Pa folur me mua
Pa më shikuar
U ngrit
Vuri
Kapelën në kokë
Veshi
Mantelin e shiut
Sepse binte shi
Dhe u nis
Nëpër shi
Pa një fjalë
Pa më shikuar
E unë, unë kapa
2
Kokën me duar
Dhe qava.

*Poezia është marrë nga libri "Diell nate", përzgjedhur dhe përkthyer nga Rexhep Ismaili

Me shkrimtarin Besnik Mustafaj

ASGJË S'MUND TA PENGOJË BASHKIMIN KOMBËRAR NË FUSHËN E KULTURËS

Fryma e europianizimit në kulturën shqiptare u mboll qysh në Mesjetë dhe është doemos e lidhur me veprën madhore historike të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, i cili e përcaktoi, pakthyeshëm identitetin e shqiptarëve si europianë



Bisedoi: Avni HALIMI

Besnik Mustafaj (1958) është një nga shkrimtarët tanë më të shquar. Në vitin 1991 ishte përkrah Sali Berishës dhe Azem Hajdarit në kryengritjen studentore kundër regjimit komunist. Një kohë të gjatë u mor edhe me politikë aktive, duke qenë deputet, ambasador dhe ministër i jashtëm. Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë: frëngjisht, anglisht, italisht, gjermanisht, greqisht, arabisht etj. Me zotin Mustafaj bisedojmë për çështje aktuale që kanë të bëjnë jo vetëm me kulturën shqiptare, por edhe më gjërë.

Hejza: Nëse moderne quhet e gjithë ajo që shkëputet prej traditës, ndërsa tradicionale ngelet gjithë ajo që i reziston modernizmit, atëherë ku ta gjejmë kufirin në mes të krijimtarisë tradicionale dhe krijimtarisë moderne?

Besnik Mustafaj: Bodleri thotë se modernia i ka rrënjët të futura thellë te tradita. Unë bashkohem me këtë vlerësim. Ai është shprehur kështu në

një periudhë kur jo vetëm kishte lindur, por edhe ishte qartësuar, pra ishte rritur ajo, që në historinë e letërsisë njihet si "moderne". Artur Rembo e kishte përmbyllur veprën e tij. Simbolizmi, si shkollë e re estetike ishte imponuar ashtu si natyralizmi i Zolait në prozë kishte marrë të drejtën e qytetarisë. Këta janë pak shembuj nga letërsia, por mund të sillen edhe shumë e shumë të tjerë, pa shkuar te piktura dhe muzika. Letërsia dhe arti, që do të quheshin moderne, po pasuroheshin me një frymë të re, e cila buronte nga zhvillimet e vetë shoqërisë europiane, duke u pajisur edhe me forma dhe mjete të reja shprehëse të përshtatshme për këtë frymë. Pra, nuk ka një datëlindje të modernes. Është një proces. Rrjedhimisht, më duket e pamundur vendosja e një kufiri të qartë ndarës midis traditës dhe modernes. Është diçka e ngjashme me kufirin midis stinëve. A ka një kufi ndarës të dallueshëm midis dimrit dhe pranverës? 23 marsi? Por ndërkohë, para kësaj date, kanë çelur lulet, ka lulëzuar gjethi, janë bërë mbjelljet e para.

Hejza: A mund të quajmë moderne në letërsinë tonë tradicionale. Në ç'forma e kemi të përfshirë traditën në letërsinë tonë moderne?

Besnik Mustafaj: Në të njëjtën logjikë më vjen edhe përgjigja e kësaj pyetjeje. Pra, që nuk do të kishim letërsi moderne shqipe pa rrënjët e saj në letërsinë tonë të traditës. Kam parasysh kështu jo vetëm letërsinë e shkruar, atë me autor, por edhe letërsinë gojore, tekstet e këngëve, përrallave, legjendave, miteve. Pyetja juaj se në ç'formë e kemi të përfshirë këtë traditë në letërsinë tonë moderne do të kërkonte një trajtim të gjerë, teorik dhe nuk është kjo bisedë vendi për ta bërë. Por as unë nuk kam kompetencë të mjaftueshme për ta bërë. Shkurtime do të thosha se shkrimtarët tanë moderne, po përmend vetëm dy shembuj, Migjeni dhe Mitrush Kuteli, kërkojnë te kjo traditë çfarë është universale, e gjithëkohëshme dhe e veshin atë me imagjinatën e vet, e cila është imagjinata e njeriut të kohës kur jeton shkrimtari në fjalë. Imagjinata e çdo brezi është natyrisht evolutive sepse ndjek zhvillimin e qytetërimit, madje në rastet më të mira edhe i paraprin këtij zhvillimi. Të tilla kumte universale e të gjithëkohshme janë marrëdhëniet e njeriut shqiptar me vdekjen, me dashurinë, me atdheun, me politikën e disa të tjera të ngjashme.

Hejza: A mund të flasim për ngjizjen e europianizimit të kulturës shqiptare sidomos në politikën paksa më liberale në fushën e artit gjatë periudhës së Mbretit Zog në Shqipëri dhe, shumë më vonë, në viset e ngela jashtë shtetit amë. Në çfarë niveli e kemi sot evropianizimin e kulturës shqiptare dhe në cilat segmente të kulturës mund të haset më qartë ky evropianizim?

Besnik Mustafaj: Fryma e europianizimit në kulturën shqiptare u mboll qysh në Mesjetë dhe është doemos e lidhur me veprën madhore historike të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, i cili e përcaktoi, pakthyeshëm identitetin e shqiptarëve si europianë. Le të kujtojmë si shembull dy veprat e Marin Barletit, "Histori e Skënderbeut" dhe "Rrethimi i Shkodrës"! Me çfarë tregojnë, mënyra si e tregojnë, arsyeja e brendshme që ka pasur autori për t'i shkruar si dhe gjuha, në të cilën i ka shkruar – latinishtja – këto dy vepra i përkasin thellësisht Rilindjes Europiane. Për më tepër, në rininë e tij Barleti kishte qenë mirëfilli ushtar në ushtrinë e Skënderbeut. Pa bërë histori, nën pushtimin

osman, deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX fryma europiane në kulturën tonë vetëm mbijetoi në sajë të përkushtimit të disa personaliteteve poliedrike të krishtera. Me ardhjen në skenë të rilindësve tanë të mëdhenj, të cilët ishin të gjithë më së pari personalitete të spikatura të letërsisë dhe të kulturës, kjo frymë europiane u përgjithësua. Sa për ilustrim, le të sjellim parasysh fotografinë e pjesëmarrësve në Kongresin e Manastirit. Një pjesë e madhe janë mirëfilli klerikë myslimanë dhe mbajnë veshjen me çallmën e klerikut. Por të gjithë zgjodhën alfabetin latin për ta shkruar gjuhën shqipe. Edhe një fakt tjetër: ne jemi i vetmi komb i dalë nga pesë shekuj pushtimi osman, për më tepër me shumicën e popullsisë myslimane, pa asnjë shenjë islame në flamur. Rilindësit tanë u kthyen te simbolet e Skënderbeut thua se pesë shekuj sundimi ushtarak, politik e kulturor osman, siç është një sundim shtetëror, nuk kishin lënë asnjë gjurmë. Periudha e Mbretit Zog përkon me ndërtimin e shtetit të pavarur shqiptar, kur lufta për europianizimin e kombit nuk bëhej më kundër të huajit, por me vetveten. Në atë kohë përplasia midis europianistëve dhe kundërshtarëve u bë një çështje qendrore për elitat shqiptare. Branko Merxhani dhe plot të tjerë zhvilluan një debat të një niveli teorik e intelektual të një serioziteti të denjë për një elitë metropolitane europiane. Për t'i rënë shkurt, do të thosha me bindje se fryma europiane në kulturën tonë sot është e rrënjësuar, mbizotëruese pa mëdyshje në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët. Problem paraqet cilësia e prodhimit tonë kulturor, i cili më së shumti nuk është në nivelet europiane. Por një kulturë vlerësohet nga majat e saj. Parë kështu, ne shqiptarët i kemi të gjitha arsyet për t'u ndjerë mirë si europianë. Mendoj se në pararojë është letërsia dhe piktura.

Hejza: Periudha komuniste, nëpër të cilën kaloi edhe populli shqiptar, prodhoi "artin zyrtar" që e luftonte dekadencën, hermetizmin, "artin për art". Me rënien e kësaj "ideologjie të kuqe" u përmbysën shumë vlera ideologjike, koncepte e mentalitete, por jo edhe krijimtaria e përgjithshme kulturore e kësaj periudhe! Ndodhi kjo sepse ne shquhemi si harrestarë të së kaluarës, sado e afërt qoftë ajo, apo sepse patëm nevojë për një "mutacion gjenetik" që do të na rikthejë drejt evropianizimit të qenësisë sonë?

Besnik Mustafaj: Periudha komu-



niste, nën të cilën jetuan për afro gjysmë shekulli të gjithë shqiptarët e Ballkanit, ishte dramatike edhe për kulturën tonë kombëtare. Ajo, që ju e quani "ideologji e kuqe" iu imponua me dhunë edhe njerëzve të kulturës. Por, provë vitaliteti është fakti se ajo nuk u bë bindje estetike për personalitetet tona më të rëndësishme. Produkti kulturor që kërkonte "ideologjia e kuqe", ishte lindor, pra, në kundërshtim me frymën europiane, që kultura jonë e kishte në gjen. Rrjedhimisht, me rënien e pushtetit politik, tek i cili mbështetej "ideologjia e kuqe", do të fshihej edhe veprimi i saj në fushën e kulturës. Po them kështu se unë nuk e shoh këtë fakt si "harresë" e shpejtë nga ana e shqiptarëve, por si aftësi e tyre për t'u kthyer shpejt në identitet. Ndodhi diçka e ngjashme me kthimin te trashëgimia e Skënderbeut pas daljes nga pushtimi osman.

Hejza: E bukura dhe madhështia e tradicionales, së vjetrës? Sa jemi si popull që e çojmë tradicionale? Faktet në terren sikur e flasin të kundërtën! Nuk e pëlqejmë të kaluarën tonë, të vjetrën nuk e konservojmë për ta ruajtur brez pas brezave, por e rrënojmë, mbi të ndërtojmë të renë! Kam fjalën për trashëgiminë arkitekturale! Nuk kemi asnjë katund-muze etnologjik! Gjithçka e re dhe pa themelet e së kaluarës!

Besnik Mustafaj: Do pranuar se shkëputja nga tradicionala është një prirje e përbotshme sot. Shqiptarët vetëm po e ndjekin këtë prirje. Ky është një vlerësim i pamjes së përgjithshme. Parë konkretisht, siç e shtroni ju çështjen në pyetjen tuaj, problemi bëhet sakaq politik. Ruajtja e katundeve - muze etnologjike është në detyrën e politikave kulturore, që duhet të zbatohen pushtetet në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup e në Podgoricë. Dhe ju me të drejtë e ngrini shqetësimin. Qeveritarët tanë

gjithandej duket se nuk e kuptojnë rëndësinë jetike që ka ruajtja dhe përcjellja te brezat e ardhshëm të kësaj trashëgimie identitare, e cila, sot, për më tepër ka edhe dobi të madhe ekonomike me zhvillimin e hovshëm, që po njej turizmi kulturor. Përgjegjësia jonë si njerëz të kulturës, por edhe si qytetarë të lirë, qëndron te presioni që duhet të ushtrojmë mbi ata, që zgjedhin për të na qeverisur.

Hejza: Si pasojë e shpejtësisë së modernizimit të përgjithshëm, a mund të themi se njerëzimi anekënd botës është edhe në një proces të motorizimit të kulturës! Këtij procesi, a do t'i shpëtojë krijimtaria letrare, nëse jo, si do të dukej një letërsi e tillë, si për nga forma ashtu edhe për nga përmbajtja. Mendim keni për digjitalizimin e letërsisë? Libri elektronik - a është ky fundi i Bibliotekës klasike?

Besnik Mustafaj: Po, mund të themi pa mëdyshje se kultura e sotme e përbotshme po i nënshtrohet një procesi motorizimi dhe se krijimtaria letrare është e përfshirë dashje pa dashje në këtë proces. Shqiptarët natyrisht që nuk do të mbeteshin jashtë këtij procesi. Unë jam ithtar i palëkundur i librit të shtypur në letër. Por, nuk jam kundër digjitalizimit të industrisë së librit. Boll që teknologjia ta ndihmojë tekstin letrar për të shkuar te lexuesi! Do të ishte e kotë dhe po aq budallëk t'i kundërvihemi digjitalizimit nën flamurin se kështu po ndihmojmë për ta shpëtuar librin. Në fillimet e epokës së industrializimit në Angli, në shekullin XVIII, shënohet "Lëvizja çartistë", ku punëtorët, me shpresën se po mbronin vendet e tyre të punës, shkatërronin makineritë që po shpikeshin. Dhe dihet sa ia arritën qëllimit. Pra, edhe në këtë rast, çdo përpjekje për të shkuar kundër zhvillimit të teknologjisë jo vetëm do të ishte e kotë, por dhe e paracaktuar për të dështuar. Shërbe-

starët e librit dhe të kulturës në përgjithësi duhet të bëhen pjesë e këtij zhvillimi, duke gjetur mënyrat më të përshtatshme për ta vënë atë në shërbim të kauzës së tyre. Kjo është bindja ime. Nga ana tjetër jam po ashtu i bindur se libri i shtypur në letër nuk do të zhduket kurrë, pra libri elektronik nuk do ta zhdukë dot kurrë bibliotekën klasike. Thjesht do të kemi disa alternativa të ekzistencës së bibliotekave letrare. Dhe aq më mirë!

Hejza: Nëse politikisht e kemi të pamundshëm bashkimin kombëtar, sepse për këtë të drejtë kombëtare nuk e kemi mirëkuptimin e botës, kush është ai që mund të na pengojë bashkimin kombëtar në sferën e kulturës?

Besnik Mustafaj: Në realitetin e sotëm politik asgjë nuk mund ta pengojë bashkimin tonë kombëtar në fushën e kulturës. Jo se nuk ka pengesa. Por, ato janë krejtësisht të kapërcyeshme. Mjafton që politikanët tanë, të zgjedhur demokratikisht tashmë në të gjitha viset shqiptare, të kenë bindjen, vizionin dhe vullnetin për t'i shërbyer një bashkimi të tillë kulturor, i cili, në të vërtetë është ushqyesi kryesor i identitetit tonë kombëtar, pavarësisht kufijve ndarës shtetërorë, brenda të cilëve jetojmë. Ama, do të thosha se fakt është që dekadat e fundit janë shënuar hapa të rëndësishëm në rrugën e këtij bashkimi. Kjo duhet vlerësuar. Problemi është se edhe këto përparime ende janë fragmentare, pa koherencë të madhe dhe kjo vjen pse ato nuk janë pjesë e një platforme politike të strukturuar mirë e të hartuar bashkërisht nga qeveritarët tanë në Tiranë, në Prishtinë e në Tetovë pa harruar edhe shqiptarët e Luginës dhe ata të Malit të Zi.

Hejza: Besnik Mustafaj, me të kuptuar opinionin se po shkruan, se së shpejti do të dalë me një projekt të ri

letrar, sakaq shton kureshtjen për ta pasur sa më parë krijimtarinë e fundit të shkrimtarit. Ëfarë është duke shkruar për momentin Besnik Mustafaj!

Besnik Mustafaj: Po shkruaj një roman, të cilin shpresoj ta përfundoj deri në verë, për ta botuar në vjeshtë, në prag të panairit të librit të Tiranës.



PËMENDJA E ASHIK KENZIUT PËR KODRËN E BALLTEPESNË TETOVË

Ashik Kenziu e përmend edhe pozitën e qyteteve dhe fshatrave që zgjaten në vijë ajrore nga kodra e Balltepes. E përmend Dibërën, Kërçovën, fshatin Zhelinë, fshatin Saraqinë të Tetovës, që janë në drejtim të Shkupit, e përmend Shkupin, Ohrin

Metin IZETI

Ashik Kenzi ka lindur në Qipro në vitin 1210/1834 dhe dihet se emri i tij i vërtetë është Ibrahim Kasım. Kenzi, i cili emigroi në Anadoll në moshën 12-vjeçare me familjen e tij dhe u rrit në teqetë bektashiane, njihet si një rapsod dhe poet i cili ka kënduar edhe me sharki. Kenzi, ka lëvizur në jug dhe në perëndim të Anadollit, në viset e Ballkanit dhe shumë vise tjera të shtetit Osman. Më pas ai është martuar dhe është vendosur në Edrene, por nuk qëndroi kohë të gjatë aty. Pasi kreu shërbimin ushtarak në Maroko, u kthye në Qipro, por rrugës u ndal në Egjipt dhe gjatë qëndrimit aty ka shkruar një poemë, ku e ka lavdëruar pashain shqiptar të Egjiptit, Mehmet Ali Pashën nga Kavaja, i cili aso kohe ishte guvernator i Egjiptit. Ashik Kenzi ka pasqyruar në poezitë e tij vendet që ka vizituar, luftërat në të cilat ka marrë pjesë dhe përshtypjet e tij. Ai, në vitin 1822 e ka vizituar Tetovën dhe ka shkruar disa poema për mikpritjen nga pashai shqiptar i Tetovës, Abdurrahman Rasim Pashai, më pas, për një trim të rrallë të Tetovës, i cili e ka pasur emrin "Sylë".

Një nga poemat e tij, që i ka shkruar gjatë vizitës në Tetovë, është edhe poema për kodrën e Balltepes, ku ai ka qëndruar në veroren e Abdurrahman Pashës, pra në kalanë e Tetovës.

Në poemën që e ka titulluar "Dasitan Nazm-i Evsaf-i Baltepe (Poemë e rimuar për cilësitë e Balltepes)", ai në detaje i ka përshkruar godinat e verores (kalasë) së Abdurrahman Pashait dhe pamjen e Tetovës me fshatrat nga kjo kodër.

Ashik Kenziu poemën e tij për kodrën e Balltepes e fillon me këto vargje:

*Cilësitë e Balltepes të përshkruaj
A më lejon, zotrote i dashur, të shkruaj
Godinat që në të janë unë t'i tregoj,
Një nga një, zotrote, t'i sqaroj.*

Që në fillim të poemës, Ashik Kenziu, tregon se ndërtesues i verores në kodrën Balltepe është Abdurrahman Pashai:

*Balltepe, është një kodër e lartë
Rasim Pashai hodhi aty një bazë
Unë s'kam pa ndërtesë më të bukur
Edhepe në shumë vende jam dukur.*

Gjatë përshkrimit të mureve të kompleksit në kalanë e Tetovës, ai flet me entuziazëm dhe thotë:

*Dy arshin të trashë e ka çdo murrë
Asgjë s'është ngat tyre fortifikata e Vanit (qytet në Turqi)
Në grykë është vendosur e kontrollon çdo anë
As një zog, fshehtas, nuk mund të fluturojë.*

Në vargjet në vazhdim Ashik Kenziu e përshkruan pozitën strategjike dhe të bukur që e ka verorja e Abdurrahman Pashait:

*Gjoksin, në malin Sharr, e ka të mbështetur
Njërin krahë në drejtim të Prizrenit e ka zgjatur
Thelbin e ka me Zotin, fytyrën në kible të kthyer
Katër anë i sheh, zotrote, është e vyer.*

Ashik Kenziu në këtë poemë, që mendoj se është e rëndësishme së veçantë, i përmend edhe tyrbet e të mëdhenjve shpirtërorë që kanë qenë të varrosur aty dhe përreth:

*Nga njëra anë është Baba Jarani i shpellës
Karshi qëndron Sersem Ali Baba prekës
Katër anët, evliatë, ia mbrojnë
Njëri prej tyre është Kojun Baba, i thojnë.*

Baba Jarani është një prej baballarëve bektashi që është i varrosur në kalanë e Tetovës, ndërsa tyrbja e tij është prishur nga ushtarët serb në periudhën e luftërave ballkanike. Sersem Ali Baba është themeluesi i teqesë bektashiane në Tetovë, ndërsa Kojun Baba është themeluesi i teqesë bektashiane në fshatin Shipkovicë në malësi të Tetovës.

Në vargjet në vazhdim Ashik Kenziu e përmend edhe pozitën e qyteteve dhe fshatrave që zgjaten në vijë ajrore nga kodra e Balltepes. E përmend Dibërën, Kërçovën, fshatin Zhelinë, fshatin Saraqinë të Tetovës, që janë në drejtim të Shkupit, e përmend Shkupin, Ohrin.

Gjithashtu në vargjet e kësaj poeme të gjatë, Ashik Kenziu e përshkruan edhe anën estetike të arkitekturës dhe dekorimeve që janë bërë në kalanë e Tetovës nga Abdurrahman Pashai. Thotë që në muret e ndërtesave kanë qenë të vizatuara një numër i madh i qyteteve të mëdha të shtetit Osman, kopshti ka qenë i mbushur me lule të sjella nga vende të ndryshme të lindjes dhe perëndimit, ajri në këtë pjesë të kodrës ka qenë shumë i pastër dhe i freskët. Poeti veroren e Abdurrahman Pashait në kalanë e Tetovës e krahason me kalatë e famshme të shtetit Osman, ndërsa Abdurrahman Pashain e lavdëron për mikpritjen, zemërgjerësinë dhe përkushtimin fetar që e ka pasur.

Në vargjet e fundit të poemës, Ashik Kenziu, i kërkon një kalë Abdurrahman Pashait për të shëtitur viset e ndryshme të shtetit Osman, të cilin edhe ia dhuron Abdurrahman Pashai.

Ashik Kenziu ka qenë i mahnitur nga bukuritë e Tetovës dhe mikpritja shqiptare e bërë nga Abdurrahman Pashai, prandaj edhe ia ka kushtuar një poemë edhe vetë pashait, por për këtë poemë do të themi diçka në shkrimin e radhës.



ANNIE BANNISTER SPENCER

Ditën e gjashtë të shkurtit 1882 lindi një grua e zezë në Amerikë, Annie (Bannister) Spencer, që me kalimin e kohës u shndërrua në simbol të luleve shumëngjyrëshe. Shtëpia private që trashëguan prej saj pasardhësit e familjes në Lynchburg është bërë sot kombëtare, vend pelegrinazhi i admiruesve të së bukurës dhe quhet "Kopshti Muze i Anne Spencer". Përpara kësaj kishte arritur të depëronte muret e ftohtë të racizmit, për të shënuar emrin e saj në histori, si e para grua e zezë, që u përfshi tek "Norton Anthology of Modern Poetry" (1973).

Njohu burrin e saj të ardhshëm, Eduard Spencer, kur ishin të dy studentë të Seminarit Teologjik të Virxhinies, në Lu. U martuan më 1901 dhe Anne filloi punë si bibliotekare. Çifti Spencer u trashëgua me tre djem, njeri prej tyre, Chauncy, shkëlqeu si pilot në Flotën Ajrore Amerikane.

Ndërsa vazhonte punën e saj si "kujdestare librash" në Lynchburg, u përfshi thellë dhe me pasion në "Rilindjen e Harlemit", si aktiviste e njohur e "Grupit të Negërve të Rinj". Sallonit i shtëpisë së Spencërve mikë-priti njerëz të njohur të jetës shoqërore amerikane të njohur, intelektualë, shkrimtarë dhe veprimtarë të të drejtave të njeriut.

Anne Spencer nisi e vonuar përfaqësimin tek Letrat Amerikane. Ishte 40 vjeç kur nxori në dritë krijimin e parë. Arriti të botojë një numër të vogël poezish në jetën e saj, rreth 30, por mjaftuan ta ngrinin në pedestalin e poeteve më të njohura të SHBA. Anne Spencer dashuronte gjithashtu lulet, kishte një kopsht të mrekullueshëm pas shtëpisë së saj të "vikendeve" familjare, të quajtur Edrankal, të cilën i shoqi ia ndërtoi si "studio të posaçme krijimi". Aty mbolli mrekullitë e veta poetike, aroma e të cilave u përhap në të gjithë Amerikën.

Kur filloi të botonte poezi, një redaktor, James Weldon Johnson, tjetër personalitet i "Rilindjes së Harlemit", e këshilloi t'i nënshkruante krijimet e saj me pseudonimin e shkurtër "Anne Spencer". Me këtë emër u bë e njohur në Amerikë dhe mbeti e pavdekshme. Ashtu si lulet e kopshtit të saj të "vikendeve" krijuese, që u bë Muze Kombëtar.

Përveçse poete dhe botaniste e pasionuar, Anne Spencer ishte edhe "furnizuese" e shtypit amerikan me "të papriturat e çuditshme", herë-herë "skandaloze" të karakterit të saj, që shpesh "nuk i përshtatej" një "personaliteti të botës afroamerikane të gjysmëshekullit", siç qe ajo. Preferencat e saj në veshje, siç qenë pantallonat, tendencat për të ndryshuar sistemin konservator të arsimit, kundërshtimet e shpeshta ndaj supremacisë së të bardhëve, e vunë shpesh në shënjestër. Në një veprim spektakolar, Spencer ofroi shtëpinë e saj si strehë për veprimtarin kongolez të të drejtave të njeriut, Ota Benga, i cili u rrëmbye, u mbajt zinxhir-lidhur në një kluvë të hekurit dhe u nxor më 1904 për t'u shitur në skllavopazarin e Luizianës. Ku gjest i saj tronditi gjithë vendin.

U amshua 93 vjeçare, pasi humbi betejën me kancerin, më 27 korrik 1975 dhe u preh pranë të shoqit, i cili ishte ndarë prej saj njëmbëdhjetë vjet më parë.

Më 2016, Biblioteka e Virxhinias nderoi bashkëshortët Spencer, si çiftin me ndikim të jashtëzakonshëm në historinë e vendit. Më 2019, Shërbimi Postar i SHBA-së njoftoi se Spencerët do të shfaqen në serinë kartpostale "Forever", në nderim të personaliteteve të Harlemit, në një kuartet me Alain Locke, Nella Larsen dhe Arturo Alfonso Schomburg.

Përgatiti dhe shqipëroi: GRIGOR JOVANI, Athinë, shkurt 2023

SI KENDOJNË DHE VDESIN POETËT!

"Ah, si këndojnë dhe vdesin poetët!
Bën një këngë dhe ta merr Parajsa.
Ke një zemër dhe Bukuria ta plasarit.
Chatterton, Shelley, Keats dhe unë...
Ah, si këndojnë dhe vdesin poetët!"

(Nga The Book of Smerikan Negro Poetry)



Botime të veçanta

LEKSIKONI I ARTEVE DRAMATIKE

Autorët e këtij libri, emra shumë të njohur në letrar shqipe, kanë sjellë një lëndë të vëllimshme me interes për opinionin kulturor, studentët, kritikët e artit dhe studiuesit

Isak AHMETI

LEKSIKONI I ARTEVE DRAMATIKE, i autorëve: Prof. dr. Luljeta Isaku dhe Prof. dr. Nebi Islami (botues INSTITUTI ALBANOLOGJIK I PRISHTINËS, Prishtinë, 2012) është një vepër me vlera të veçanta. Autorët e këtij libri, emra shumë të njohur në letrar shqipe, kanë sjellë një lëndë të vëllimshme me interes për opinionin kulturor, studentët, kritikët e artit dhe studiuesit.

Me këtë libër autorët i kanë dhënë një kontribut të çmueshëm sistemimit dhe konsolidimit të kësaj materie ndër ne, të munguar dhe të shkapërdërdhur. Veçantia e këtij Leksikoni, të cilin po e marrim në shqyrtim, qëndron në faktin se, krahas zhvillimeve në fushat e arteve dramatike botërore, të cilat jepen në diakroni dhe sinkroni që nga antika e deri në kohët tona, sjell shembuj paradigmatic mbi ndikimet dhe fluidat e tyre në artet tona dramatike si dhe gjendjen aktuale të saj. Një cilësi e veçantë e këtij Leksikoni, siç e ka vërejtur edhe Prof. dr. Remzi Nesimi është se sjell më shumë zëra nga hapësira etnike e krijuesve nga ish Jugosllavia, me theks mbi zhvillimet në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës, që deri tash tërësisht kanë munguar. Vlen të theksohet se përmes këtij Leksikoni, autorët kanë dhënë një pasqyrë bazike e të domosdoshme mbi zhvillimet botërore dhe reflektet e tyre në zhvillimet brenda nesh. Thekset këtu janë vënë më tepër tek autorët këtej kufirit të


Shqipërisë administrative, ndërsa janë përfshirë ata zëra nga Shqipëria për të cilët autorët gjykojnë se janë më meritoret.

Përkundër përkushtimit dhe punës shumëvjeçare, autorët janë të vetëdijshëm se libri mund të ketë edhe dobësi për shkak të heterogjenitetit të materies dhe mënyrës së valorizimit, e cila, sipas autorëve, ka nxjerrë në syprinë subjektivitetin për selektimin dhe reprezentimin e lëndës e hapësirës që duhej dhënë zërave përkatës.

Megjithatë, autorët janë të bindur se ky Leksikon do të jetë ndihmesë për veprimtarët e kulturës, për studentët, por edhe për studiuesit të cilët mund ta shfrytëzojnë si bazë për t'i thelluar hulumtimet në fushën përkatëse, sepse mundëson, siç e kanë theksuar me të drejtë edhe autorët me rastin e botimit të këtij Leksikoni, relativisht shpejtë, thjeshtë dhe lehtë të orientohen dhe t'i marrin informatat e domosdoshme.

Ky Leksikon, sipas autorëve, lehtëson punën për të sqaruar termin e panjohur dhe definicionin e ngjeshur të nocionit përkatës, të dhënat dhe vitet e caktuara, periudhat e zhvillimeve përkatëse, drejtimet apo formacionet stilistike, njohuritë lidhur me rrymat ideore, me konceptet letrare, sociale, filozofike dhe përfaqësuesit karakteristik të kohës.

Krejt në fund le të theksojmë se ky është një libër me vlera të veçanta, është një libër me cilësi të theksuara, për çka autorëve u takon një mirënjohje e veçantë!



Mbi poezinë e Sulejman Matos

BALENAË E DETEVE TË LARGËT TË NJË POETI TË SPIKATUR

Poet i përthyerjeve të befta dhe metaforave të tejdukshme. Poezia e tij sa herë e lexon është e aftë të të mbjellë në shpirt vetëm ndjenja të holla dhe një psherëtimë ngazëlluese.



Agim BAJRAMI

Një libër i mirë është i aftë të të shkaktojë një drithërimë të veçantë gjatë gjithë kohës leximore, por edhe të të shoqërojë me figura dhe imazhe të gjallë jetësorë. Unë nuk them se nga drita dhe ngjyrat e gjalla të këtyre imazheve mund të të lëbyren sytë, por kam të drejtë të këmbëngul, që mbas leximit të këtyre poezive, mund ta ndiesh veten si një tren të pakthim, që lëviz e lëviz gjithmonë drejt peizazheve të së nesërme. Dhe kjo sepse, poezitë e Sulejman Matos kanë një prirje të kultivuar, të prishin realitetet ekzistues të leximit, edhe vetëm me një zgjatje të beftë të zërit, apo theksimit të një tonaliteti zanor, duke ndërtuar kështu virtualisht para teje të tjerë realitete të bukur (edhe pse jo njëqind për qind të ngjashëm me ato të ëndrrave të mëngjesit. Sulejman Mato bën pjesë padyshim në ata pak poetë, që me plot gojë mund të themi se numërohen vetëm me gishtat e njërës dorë. Ai hyri në poezinë tonë jo për t'u bërë "një nga ata që shkruajnë" si gjithë të tjerët, por si një penë krejt e veçantë,

si frymë poetike dhe kaligrafi shumë e ndryshme nga bashkëkohësit e tij. Të para në kënde të ndryshëm vështrimorë poezitë e Matos mund të konsiderohen jo vetëm si krijesa me frymëmarrje të thella lirike, por edhe si portrete të gjallë dashurish pa stereotipa, që autorët pararendës të tij i mbanin nën jastëk, pasi kishin frikë t'i ekspozonin. "Poeti, si strehues dhe rrëfimtari epik i balenës së ardhur nga dete të largët, nuk është gjë tjetër, veç se portreti i stilizuar i unit poetik të tij, që nga fillesa e deri në vijimësi. Në këtë simbolikë kaq interesante dhe origjinale, ku motivi bazë është ekzistencializmi dhe qëndresa, e individit në një shoqëri tinzare dhe plot vese, autori gjen rast të shpërthejë dhe të flakë ndaj saj shkëmbinj proteste. Të zbërthesh frymën poetike të Sulejman Matos, nuk është fort e lehtë. Lexuesit dhe jo vetëm atij, do t'i duhet më parë të udhëtojë fizikisht dhe shpirtërisht nëpër labirinte vitesh dhe peizazhe qytetesh të vegjël dhe metropolitanë evropiane, të ç'mitizojë mite të ardhur në trajtat e tyre fillestare që nga antikiteti, si dhe të përshkonte distanca largësish

ndërplanetare drejt viseve ku është strehuar "flokëbardha e tij yjore", nëna. Është ky moment ku poezia dhe poeti bëjnë një shkëputje të beftë nga rutina e gjërave të thjeshta dhe të zakonshme, për t'ju kushtuar tërësisht të jashtëzakonshmes, baladeskes dhe legjendës njëherësh, kalimit të portave të Hadit dhe takimit me nënën e vdekur dhe të shndërruar tashmë në një kometë që lëviz. Kjo poezi mister që ngjan me "Nënë e Eseninit" ka pika takimi me të vetëm nga madhështia dhe solemniteti, por që është konceptuar dhe artikuluar nga autori një formë krejt të ndryshme. Nëse nëna e Eseninit vjen e mbështjellë me ngjyra nostalgjish tokësore, nëna e Matos është e krijuar totalisht nga një materie kozmike. Është një poezi sa e prekshme aq dhe hyjnore, ku shenjat e qiellit dhe të tokës janë përzier e bërë një dhe ku kohërat e largëta ushqejnë shpesh ato të rejtat me një dritë fosforike. Poezia e Matos është shumëdimensionale, zhurmë guralecësh të rrëzuar dhe dridhje e beftë që shkaktohet nga një krah pëllumbi, rrugicë e mbuluar nga bari në brigjet

me ullinj të vendlindjes, si dhe heshtje gurësh të një shtëpie të vetmuar, vaji i zi mëllenjash, por mbi të gjitha është edhe një demokraci bari dhe shiu (edhe pse ndonjëherë kjo poezi merr përsipër të përgjojë edhe bisedat profetike të burrave jonianë në male dhe t'i sjellë ato të transkriptuara besnikërisht). Natyrisht, për të transkriptuar këtë gjuhë zotash që për autorin nuk qëndrojnë vetëm në qiell, atij i janë dashur dekada të tëra përpjekjesh dhe sakrificash homerike. Duke bërë pjesë në aradhën e vogël të atij brezi entuziastësh që u rritën dhe zhvilluan artistikisht në vitet 60, poeti dhe poezia e tij pasi flakën si një mish të huaj deklamacionin dhe stereotipat shterpë të socrealizmit, e veshën vetveten me më shumë liri dhe hapësira shprehje. Për këtë ata ju drejtuan gradualisht simbolikës si bartëse të unit të tyre Guri, Balena, Deti, Anija, Poseidoni, Itaka etj. janë objekte kaq të ndeshur në krijimtarinë e tyre. Është në natyrën e poetëve të mëdhenj rendja drejt modeleve dhe koncepteve të reja bashkëkohorë, duke futur brenda tyre shumëçka nga idetë që lëviznin

përreth tyre. Kjo i ka bërë poezitë e tyre konceptuale, të hapura dhe me kohë të ardhme të pakryer. Lind pyetja: përse lexuesit përftojnë një shije tjetër nga leximi i tyre? Përgjigja mund të ishte e tillë, sepse Sulejmani dhe gjithë poetët e nivelit të tij sollën një mënyrë tjetër ligjërimore. Ata ishin të neveritur nga mënyra standarde e të shkruarit të asaj kohe, metodë sa tradicionale aq dhe e ngurtësuar, dhe totalisht e paaftë për t'ju përgjigjur aftësive krijuese të tyre.

Për këtë Moikom Zeqo do ta quante poetin në fjalë një lirik autentik, që di t'i falet në poezi vetëm sentimentit dhe ndjeshmërive njerëzore. Të dyja këto kanë mbetur dhe do të mbesin si të vetmet realitete të shpallura apo të pashpallura të tij. Ndaj s'është vetëm bindja ime, por edhe e shumë të tjerëve njohës të mirë të vargut, që poetika e tij s'është gjë tjetër, përveç se një qenësi në ngjyrë të kaltër, që formën dhe strukturën e saj e vë gjithmonë në funksion të mesazhit bazë.


"Përmes një qingji të tingullit, nga zjarri i gjithësisë, dola unë, thotë në një nga poezitë e tij poeti metaforikisht, duke ia lënë heshtjes të merret më pas me akustikën e vijimësisë.

I kursyer në fjalë, por jo në shenja dhe lëvizje, shpesh dhe me një çelës në brez, kaq i ngjashëm me "Dajke zonjën" çdo varg i poezisë së Matos përcjell krahas tensioneve dramatike të brendshme, edhe një mërmërimë gjegjesh limoni dhe kopshtesh në pranverë. Shumë nga poezitë e autorit filluesen e kanë nga bisedat e tij me yjet dhe universin misterioz. Ndërthurja e fiksonit me realitetin gjithmonë ju ka dhënë atyre një vel misteri dhe karakteristikë artistike. Ky është një shkak që heronjtë dhe heroinat lirike të Matos dallojnë qartas nga të tjerat, jo vetëm nga timbrika e zërit dhe portretit, por mbi të gjitha nga mënyra e komportimit dhe e përthyerjes së tingujve. Është një përthyerje autentike që vjen tek ne herë në trajtë këngësh bregdeti e herë të tjera në trajtë baladash baritore, me një fluiditet zërash dhe forcë përfytyrimi. Poezia "Fyelli" p.sh., merr përsëri të na pohojë shkurt e qartë veprimin e mëposhtëm që:

- Një bari preu një degë panje
I hapi shtatë vrima dhe i tha; këndo
Këndo, ose qaj, Kjo është detyra jote

Mjafton vetëm edhe kjo thirrje urdhërore që peizazhi baritor të zgjohet nga dremitja, për t'ju falur më pas këngës së botës. Panja fillon të prodhojë tinguj, birat të nisin t'ju japin atyre nota të ndryshme dhe baladat të ribëjnë vetveten. Edhe pse në kushte të një censure socrealiste, poezitë e shkruara prej tij në diktaturë kanë mundur të ruajnë sharmin dhe pjesë të caktuara të shpirtit të tyre rebel, dhe kjo sepse brenda aparatit krijues të tij ka vepruar gjithmonë thënia filozofike: "se për të hapur një derë dhe për të kyçur e ndërthurur një ëndërr, duhet me patjetër një rreze drite". Poezitë e Sulejmanit gjithmonë tentojnë të flasin me lexuesit me "letra" dhe dyer të hapura. Është e dukshme se ato nuk duan të mbartin sekrete më vete. Bashkëvepruese dhe komunikuese me gjithçka që kanë rreth e rrotull, ato "bashkojnë zërat dhe qeleshet kokë më kokë me njëra tjetrën", për të

krijuar më pas suksesshëm një polifoni të rrallë jugu. Ja pse kur i lexon ato të ngjan sikur bashkë me metaforën qendrore të vargut dhe këngës, ke futur brenda vetes edhe "Kostandinin e vdekurth", "Tre vjet i patretur" etj. Vini re mbaresat me kuptim përkëdhelës dhe përmallues që ju vendos autori këtyre vargjeve. Janë mbaresa jo vetëm përkëdhelëse dhe identifikuese, por edhe metafora ringjallje dhe ripërtëritje. Kjo jo vetëm e ka bërë aparatit përfytyrues poetik më të fuqishëm, por edhe më mistik njëherësh. Në poezitë me temën e qëndresës vihet re mbushja e hapësirave dhe peizazheve historike me tinguj dhe epicitet vendlindje. Autorit nuk i durohet sa të na e bëjë të qartë prejardhjen e tij nga brigjet dhe malet epike të Akrokeraunëve. Ashtu si në tragjeditë e Eskilit, edhe këtu klithma e një kobi të pritshëm qëndron ndehur në ajër. Kuaj profetik që dredhojnë nëpër shtigje misteresh me bishtin që ua merr era, ura qabeje, mushka Grebeneje, pashallarë me mjekra të çuditshme, komitë që shkojnë zallit me jetën dhe vdekjen poshtë nën gunë, që flasin një gjuhë



me një theks dhe dialekt të egër hakmarrës, që s'mund të mbyllet dot kurrë pa një kurban. Pikërisht duke huazuar ose bërë të vetat shumëçka prej këtyre pamjeve të rralla, autori ka ditur të ndërtojë edhe strukturat e këngëve të tij të mëvonshme, kaq të veçanta. Kështu p.sh. në poezitë kushuar vendlindjes, krahas njerëzve dhe kafshëve të shtëpisë, vihet re një pjesëmarrje dhe shpirtëzim i gjerë, i elementeve të natyrës, pemët e oborrit, shtëpitë, shkëmbinjtë, bregu, deti, valët, portokajtë, dielli, jugu etj. Janë elemente që në kontekste të caktuara marrintribute të barasvlershme me shenjtët, para të cilëve autori falet. Për një njohës të poezisë, kjo natyrisht nuk përbën ndonjë risi. Risia këtu është mënyra e veçantë e komportimit që ka ky autor në krahasim me të tjerët. Duke i vizituar objektet e dashur poetikë të Sulejman Matos, mua më vijnë në mend damarët e hollë dhe të tejdukshëm të gjetheve të pyllit rus, pikturuar me aq dashuri dhe mjeshtëri nga Shishkini. Më pas s'di pse më pëlqen t'i shndërroj në valë të kaltra ato gjethe, duke përfytyruar fill mbas tyre edhe sytë e shqetësuar të poetit të shquar jonian:

Një pako e thjeshtë e lidhur me spango
Me kujdes me merakun e njerëzve

të jugut

Nën lëkurën e portokalleve ka erë
jodi
pikëzim dielli dhe vese yjesh
Ngrohtësi pranverë,vesë jonike

Mato është një poet që aftësive të tij reflektuese di t'i shtojë edhe thellësinë e vështrimit dhe forcën e gjykimit. Heroi lirik i kësaj poezie ka një individualitet dhe mënyrë krejt të shpenguar lëvizje dhe shprehje. Ai e di nga vjen dhe po ashtu e di edhe se ku po shkon. Në krahasim me shumë poetë të kohës së tij, që vuanin formatet e ndrojtur dhe të mbyllur shprehimorë, poezia e tij është një thirrje e zgjatur për më shumë ajër dhe vetëdije autoriale. Shumësia e elementeve të shprehjes dhe guximi i pohimit, janë të shkruara edhe me një figuracion të pasur dhe shumësi elementesh narrativë. Një tjetër tipar i kësaj poezie që e radhit atë ndër poetet më aktivë të kohës së tij është tema sociale. Poeti dhe vargu kanë një marrëveshje të shpallur mes tyre. Ky është shkak që ky varg di të marrë si me urdhër trajtat e format e gjendjeve të

ambientet tipike jugore, vetminë e brezit të vjetër dhe largimin e bijve në emigracion. Është një grumbull portretesh poetikë, për të cilët nocioni kohor ka humbur kuptimin:

Kur do të na vijnë djemtë tanë,
pyesin ato hënën
Një hënë të ftohtë dhe mernece

Prirja e autorit për t'i dhënë gjithçkaje format dhe dimensionet përkatëse, e ngarkon, i jep më shumë peshë dhe konotacion fjalës dhe mendimit. Shembulli i kësaj që sapo thamë është poezia "Kujtimi" i vitit 1948:


Në Fterrë binte shi
Në stane binte bore
Ethem Malo o bukuri e maleve të mia
Ke 50 vjet që ulërin
Ulërima e një ujku lartësohej maleve
Askush nuk e pa betejën legjendare
Vetëm baloja i tij i përgjakur
Dhe delet që e ruajtën gjatë në kujtesë

Në konceptualitetin krijues të Matos gjithçka i ngjan ajrit, erës dhe lumit, pra një trioje që lëviz dhe është vazhdimisht në një ikje pa kthim.

Musa Vyshka e karakterizon poezinë e Sulejmanit si "gazmore", të sinqertë" dhe të "shkujdesur". Pa dashur ta kundërshtoj atë, krahas fjalës shkujdesje, unë do të shtoja edhe "se kjo lloj poezie është edhe një përjetuese e thellë e gjendjeve shpirtërore të poetit në opozitë të përhershme me realitetet tona absurde, me të cilët ai nuk ndalet se polemizuar dhe kontestuar energjikisht. Është kjo arsyeja që gjatë leximit të tyre, toni i zërave nis të pësojë ulje ngritje të herëpashershme dhe të mos ndihet asnjëherë i njëtrajtshëm. Janë çuditërisht të ngjashëm me rrahjet e zemrës lirikate dhe dashurisë dhe poezitë e mallit për shokët dhe vendlindjen, ashtu siç janë të ngjashme me kambanat e vajtimin poezitë aq të ndjera për nënën apo njerëzit e tjerë të dashur, i kur nga kjo jetë. Tekstet poetike të autorit e kanë në gjen fokusimin e njeriut të pabujë, por me veti të bukura njerëzore. Në shumë këndvështrime, ai është dhe mbetet figurë mbizotëruese. Ndaj nuk e teprojmë po të themi që portretizime të tilla janë dhe mbeten nga krijimet më të bukura të tij. Sulejman Mato është një poet i planeve dhe zhbirimeve psikologjike, si dhe i peizazheve me kontrast. Tematikat dhe impresionet në korpusin poetik të tij janë të shumëllojshme dhe të shprehura me një larmi formash, nga më të ndryshmet, ndaj unë nuk do të isha shumë dakord me ndonjë krijues që e definon këtë poet, si poet i rivierës apo poet me tipologjinë krijuese të jugut. Jo! Poezitë Tirana ime, Kur ikëm i lamë të vdekurit oborreve, Njerëzit nuk i kuptojnë milingonat, Vajtim për fluturat që jetojnë vetëm një ditë, Shpirti i nënës rron, Ifigjenia në Taulidë, Oqeani, Unë jam ciklopi, Të mësohesh, Një balenë e largët erdhi nga deti, S'kemi kohë për të thënë shumë gjëra, me tipologjinë dhe mënyrën e formësimit të tyre pohojnë të kundërtën e këtyre përcaktimeve. Poet i përthyerjeve të befta dhe metaforave të tejdukshme. Poezia e tij sa herë e lexon është e aftë të mbjellë në shpirt vetëm ndjenja të holla dhe një psherëtimë ngazëlluese.

KTHEJA JETËN GJUHËS...

Po të kem mundësi ta arrij një efekt pa e përdorur një fjalë, e bëj këtë gjithmonë, mirëpo nganjëherë është diçka që s'bëhet dot



Ernest HEMINGWAY

Në të pëlqen të lexosh një libër që e ka shkruar një njeri, i cili e di fare mirë atë ç'ka shkruar dhe, për më tepër, që e ka shkruar shkëlqyer, lexo "Takim në Samarra" nga Xhon O'Hara. Pastaj, në paç kohë, lexo edhe një libër tjetër që titullohet "Lufta dhe paqja" nga Tolstoi, dhe ke për të parë se si do të kapërcesh ato pjesët ku ai shpreh Mendime të Mëdha Politike (të cilat ai, pa dyshim, pandehte se qenë gjërat më të mira që kishite në libër), sepse ato nuk janë më as të vërteta e as nuk kanë ndonjëfarë rëndësie, ndërsa shiko se sa të vërteta, të qëndrueshme e të rëndësishme, mbartin aty njerëzit dhe bëmat. Mos i lër të të mashtrojnë duke të treguar se si u dashka shkruar një libër, vetëm e vetëm ngaqë kjo tani është bërë e modës. Turgenjevi, për mua, është shkrimtari më i madh që ka qenë ndonjëherë. Nuk ka arritur te librat më të mëdhenj, por prapë qe shkrimtari më i madh. Natyrisht, ky është vetëm mendimi im. E ke lexuar ndonjëherë një tregim të tij të titulluar "Rropama e rrotave"? Është në vëllimin e dytë të "Kujtimeve të një gjahtarit". "Lufta dhe paqja" është libri më i mirë që njoh, por përfytyroje si do të kishte qenë, sikur ta kishte shkruar Turgenjevi. Çehovi ka shkruar nja gjashtë tregime të mira. Por ai qe një shkrimtar amator. Tolstoi ishte profet. Mopasani qe shkrimtar profesionist. Turgenjeve ishte artist.

Kur një prozator e njeh mirë atë për të cilën shkruan, atëherë ai mund të lërë jashtë disa gjëra nga ato që i di dhe lexuesi, po qe se shkrimtari di të shkruajë, ka për t'i ndier ato po aq fuqishëm, sa ç'do t'i kishte ndier, nëse shkrimtari do t'i kishte përmendur. Ajzbergu lëviz tërë madhësi, pikërisht sepse një e teta pjesë e tij qëndron përmbi ujë. Kurse shkrimtari që i lë gjërat pa i thënë, ngaqë nuk i di, vetëm sa krijon kështu boshllëqe në veprën e tij.

Kur shkruan pak a shumë qartë, gjithkush të merr vesh po mashtrove. Ndërsa, kur një zë i mistifikon gjërat vetëm pse nuk do t'i thotë troç - dhe kjo është diçka krejt ndryshe nga shkelja e të ashtuquajturave rregulla të sintaksës e gramatikës për të krijuar një efekt, që s'mund të arrihet dot ndryshe, - atëherë që të merret vesh se ai mashtron, duhet të kalojë një kohë më e gjatë dhe, ndërkaq, shkrimtarë të tjerë, të prekur dhe ata nga e njëjta nevojë, do të zënë ta lëvdojnë, sepse asisoj mbrojnë vetveten. Misticizmi i vërtetë s'duhet ngatërruar me paaftësinë në letërsi, e cila kërkon të krijojë një dukje misterit aty ku mister s'ka, vetëm e vetëm ngaqë u duhet për të mashtruar, për të fshehur mungesën e dijeve apo aftësinë për t'i thënë gjërat qartë. Misticizmi nënkupton mister dhe mistere ka plot; por veç paaftësia s'hyn ndër to, as teprimet gazetareske që kërkojnë të shiten për letërsi, duke marrë një ton të rremë epik! Po të kem mundësi ta arrij një efekt pa e përdorur një fjalë, e bëj këtë gjithmonë, mirëpo nganjëherë është diçka që s'bëhet dot. Por edhe gjuhës i bën mirë t'i kthesh jetën, që ia kanë marrë.

Për një shkrimtar të vërtetë, çdo libër i ri duhet të jetë një fillim i ri, një nisje e re drejt diçkaje që s'e arrin dot. Atij i duhet vazhdimisht të përpiqet të bëjë diçka, që s'është bërë ende asnjëherë e që edhe të tjerë janë rrekur ta bëjnë, por më kot. Ndonjëherë, në e ndihet edhe fati, do t'ia dalë mbanë. Në çastin që e lë të shkruarit për një apo dy muaj, kur jam në ndonjë udhëtim, ndiej një lumturi të plotë kafshërore. Por veç kur je duke shkruar dhe ia del asaj që po bën ashtu siç e do, ndien gjithashtu një lumturi të madhe, por në një mënyrë krejt të ndryshme; sidoqoftë, kur mendon se sa e shkurtër është jeta, si njëra ashtu edhe tjetra, janë njëllot të rëndësishme për ty.

Neeli Cherkovski

GREGORY CORSO

kur Gregory vdes
është një flutur e bardhë
në oborr duke mbajtur shënime
dhe duke folur me pemën e limonit
me zë të ulët e antik

kur Gregory vdes
pianistët përkulën
në oborrin ngjitur
në ditën e diplomimit
e një pikolo i vetmuar
i predikon kujtdo që kalon atypari

ai ka lindur në vitin 1930
në kohë për Depresionin e Madh
dhe u kalua nga
një dorë e çuditshme në tjetrën
ai nuk e njihje nënën e vet

**

e takova Gregoryn Avenunë Kolumbo
me poetin Andy Clausen
bartës i govatës, ata erdhën në banesën
time
dhe e lexova poezinë time "Coit Tower" në
të cilën
kulla është një hije e palosur
mbi një shtrat me lule derisa qielli rrjedh
dhe rrugët shndërrohen në një sërë
lavanderie

ai kishte poezinë e tij "Coit"
në një libër të titulluar Gasoline
një kullë kundër marramendjes
që më goditi si sfidë

**

ai mund të ketë qenë një nga poetët e
fundit bohem
nuk kishte kurrfarë diplome shkolle, nuk
punonte në universitet,
nuk kishte kurrfarë pune, përpos poezisë

derisa jetoi dhe veproi
bora binte mbi fjalët e tij,
drita e diellit
ia shponte poezitë, ujqërit shfrytëzuan
çdo mundësi që kishin
kur do të kthente qafën
drejt laureshave që iknin
nga shtrëngimi i Shelleyt,
mjeshtrit të tij, poetit gjithmonë të ri
që qante për të vdekurit

**

kur Gregory ishte
Huck Finn demoniak
ai mësoi se si të vazhdonte
rrugës zigzage, në burg
ia dhanë poezinë
dhe prozën e iluminuar

kur u lirua
gjithçka lëvizte në mënyrë poetike
në rrugët mëngjesore të vendlindjes
së tij në Greenwich Village dhe

në lagjet e Harvardit
ku botoi librin e tij
të parë me poezi

**

kur takova Gregoryn
ai ishte tashmë poet i famshëm
i Brezit Bit, ai mund
të citonte "To Helen" të Poes dhe
të festonte "llambën e agatit"

Gregory shkroi poezitë "Martesa"
dhe "Bomba", ai ma vodhi gramafonin
dhe me ato para bleu drogë,
ai e la beben Max në kujdesin
tim për javë të tëra

më fliste për Francis Villon
sikur ta kishte vëlla, e jo
poet mesjetar i kolonadave
të errëta parisiane

**

kur jeton Gregory
një bandë marshimi
ngrihet nga kopshti
dhe merr kontrollin
e gjithçkaje që është e rregullt

ai na mbajti duke u përpëlitur
për dritën e tij, ai mendonte
se vendi ynë është tepër i thjeshtuar
dhe gjeti një kompleks
të plotë të thjeshtësisë
në disa rreshta të zgjedhur mirë

Përktheu: Fadil Bajraj

MAGJIA E KUJTESËS

Fehmi AJVAZI

Nuk ka në historinë e ideve dhe të veprave autor të tyre, nun, zotërues, padron që nuk e ka provuar të paktën njëherë, momentin e fillimit të ndarjes së një pjese të kohës dhe të energjisë për t'u rrekur pastaj, me "dekadat e jetës historike", qoftë personale dhe qoftë shoqërore, nacionale, botërore etj. Pse? Sepse, ritmet e jetës krijuese e studiuese janë të këtitilla. Kornizat! Mesi dhe fundi i tyre. Të gjitha fijet e këtitilla janë të lidhura mes vete, madje edhe të koduara në kujtesën dhe historinë piramidale të 'homo sapiensit' inteligjent. Zbardhja ose shkrirja në letër, ndryshe nga mbamendja, është një gamë vezulluese, yshtëse, shkrirëse, një si testament me karakter universal! S'ka gjë më mbresëlënëse se sa ta përshkruash kohën tënde me dioptrinë e mirë të kujtesës, dhe përmes kohës tënde t'i mundësosh atij tjetrit që vjen nën diell, kohën e tij të kaluar trashëgim. Konvergjencia shkrimore, merr pastaj ngjyrat e ndryshme që simbolizojnë kohët, ngjarjet, proceset, imagjinatën, kujtesën, artin, estetikën, historinë, politikën, letërsinë etj.

Në kontekst të kësaj, as nuk duhet të ikim nga ritmet e ndryshme të jetës, sepse ato janë të mishëruara me ne, janë të bukura, gjalluese. Por po ashtu, janë edhe intriguese, e disa herë edhe të trishtueshme, epike, tragjike në kuadër të ndikimit dhe peshës së tyre! Markezi ka thënë se, jeta është vetëm ajo që na kujtohet! Në anën tjetër, të mos e kujtosht të kaluarën, gamën e saj universale, të mos i kthehesh asaj me tërë qenien, je shumë e më shumë: ose afër vdekjes, ose i gjallë - por në shtratin e saj!

Mbi të gjitha, në procesin e rrjedhës historike, rreth e rrotull dhe veçanërisht në thelb të saj, na ndodhin ide, perceptime, lëvizje, gjëra të thjeshta e delikate, punë, emocione, ëndrra, mërzi, pikëllime etj., që pa dashjen tonë na grishin fuqishëm brenda "mureve" të kujtesës piramidale. Miliona e miliarda njerëz, e përjetojnë këtë sagë në forma të ndryshme. Ditë e natë. Por, miliona e miliarda prej tyre nuk e akceptojnë mendjen, fuqinë e tyre, inteligjencën etj. Shumëçka, nuk varet prej tyre dhe kjo përbënë 'seleksionimin dialektikë' që nuk ka nevojë ta shpjegojmë sepse, zhvillimi është diçka i pandalshëm, rrotullues, riciklues si në procesin e punës së një mjeti motorik apo, si në lëvizjen e sistemeve plantare.

S'ka dyshim: më shumë a më pak trupi ynë fizik dhe psikofizik, është gjithmonë aktiv për aq sa është edhe mendja, madje edhe në gjendje pasive! E tëra, ngjanë me procese dialektike. Në anën tjetër, pa na pyetur fare ecën koha! Ecja e saj, ngjanë me një dinosaur: është e ngadalshme, por gjithnjë e pamëshirshme në hapat e saj. Koha i ka hapat shtypës, shkretues, harrues etj. Jo, kurrë s'na është kujtuar që ne shkojmë pas kohës dhe, koha kurrë s'vjen pas nesh! Dhe një ditë prej ditëve, kemi filluar ta ndjejmë vetën të lodhur më shumë se zakonisht, të "kursyer" nga idetë dhe dëshirat, kemi filluar ta ndjejmë faktin se shqisat e prekjes nuk janë më ato të dikurshmet, as shqisat e të pamurit, as shqisat e ndijimit etj. Thjeshtë, kemi filluar të plakemi! Të plakemi, deri sa pastaj jemi të detyruar t'i nënshtrohemi realitetit, një përshtatje e zorshme por e natyrshme; Koshiencia na ka detyruar me dëshirë ose pa te tu qasemi bilanceve të pështrira të jetës që kemi kaluar, rrugëve të saj, cilësive, errësirave, mistereve etj. Me një fjalë, kemi filluar t'u përshtatem imazheve që kanë filluar ta zëvendësojnë të djeshmen e ikur me të natyrshmen në evoluim të fundmë! Diçka e mjegullt dhe e trishtueshme, na i prenë gjunjët: ikja e shpejtë e kohës, mungesa e cilësisë, dhe prania mizore e pushtetit të harresës...

Jeta e ikur, do të themi në një moment të angësht, ishte për mua dhe për ty, për atë tjetrin, për të panjohurin etj., një pasqyrë e përbërë nga numrat dhe bilancet statistikore të cilat, një ditë nuk shërbejnë për asgjë. Pra, në fakt nuk do t'i shërbejnë askujt. E, më së paku neve...! Kështu, duke parë e menduar me kujdes të reduktuar, deri sa një ditë na shteron struktura e fuqisë fizike dhe e vetëdijes, na bie ndërmend edhe për "bilancet dhe cilësitë" nëse, ato janë diku ose nuk janë fare, nul...! Jeta jonë e brishtë, ka ekzistuar me të vërtetë apo ka mbetur diku,

është fshehur nëpër vrushkujt e kohës, thjeshtë: nuk është tretur...!

Epo, nuk është tretur nëse t'i e ke kuptuar qyshkur se të qenit vetëm "numër" demografik nuk parathotë asnjë vlerë për "ardhje - shkuarjen" tënde nëpër botë të cilës, t'i nuk i dhe asgjë sa ishe gjallë! Ose, je përpjekur të prodhosh njëfarë cilësie krijuese, domethënë je përpjekur të strukturosh vlera që nuk kanë qenë vetëm personale por, "vlera" që u kanë shërbyer të tjerëve, ty, dikujt...

Unë, ti, ai tjetri, ndoshta jemi përpjekur të bëjmë maksimumin! Kushedi! Ndoshta i kemi shërbyer një kohe nën hijen e diellit tonë, një rrethi të ngushtë njerëzish ose, me gjithë dëshirën s'kemi pasur kujt t'i shërbejmë! Por a u kemi shërbyer interesave të shoqërisë, të popullit, çfarë kemi bërë për historinë, gjuhën, kulturën, natyrën, shkrimin etj.? Çfarë kemi bërë për atdheun? Për botën, universin etj. Në fund të fundit, a kemi bërë diçka për të tjerët, për njerëzimin! Në këtë galimatias çështjesh të ngatëruara, t'i ke qarë ujë e turbullt të jetës, dhimbjen tënde, shpirtin tënd dhe çdo gjë je përpjekur ta bësh me njëfarë dashurie ose edhe me dashuri të plotë, në fakt, gjysmën tënde ke arritur ta kthesh në një "qiri" që ka bërë dritë për të tjerët. Ose, "kjo dritë" do vazhdojë të nanurisë në mesin e të tjerëve që kanë ardhur e do të vijin pas teje.

Në raste të veçuara unike, vepra jote s'vdes kurrë! S'ka gjithmonë rëndësi përmbajtja nëse, thelbi i saj i ka shërbyer dikujt ngase metafizika, një kompleks gjallimesh delikate, e përbën shpirtin tonë! Epo, t'i, megjithatë ke qenë gjatë gjithë kohës "krijues dhe zotërues" i unit dhe yllit tënd që, vite e shekuj mbas teje, kur t'i ke ikur s'i edhe çdo qenie tjetër njerëzore, do të vazhdojë të ndrisë "figura" jote e pavdekshme, në të vërtetë 'metafizika' s'i testament...



TJETËR TË ÇMOSH DHE TJETËR TË LAVDËROSH

Fatbardh AMARUSI (RUSTEMI)

Thuhet se vepra duhet ndarë nga autori. Nuk është e lehtë të bëhet, ja që: eruditi Lumo Skëndoja u nda nga kolaboracionisti, Mit'hat Frashëri. Thuhet se simpatia dhe antipatia nuk duhet të ndikojnë në gjykimin e veprës. Nuk është e lehtë, se ai që s'të do, të zhyt shtatë pashë nën dhë, dhe e kundërta: të çon në qiell të shtatë. Të gjithë rrëshqasim në detin e ngrirë të subjektivizmit, por ndryshe në akull dhe ndryshe në baltë. Në vend t'i jemi mirënjohës atij që na jep kënaqësi, pikërisht atij ia nxijmë jetën, ngaqë na duket se na ka vjedhur kismetin?! Nëse doni të dalloni njerëzit e kategorisë së dytë, thotë Ayn Rand, shihni nëse ata hidhërohen, kur dikush arrin një sukses. Por, kush e certifikon suksesin? Në një postim të fundit; poeti, shkrimtari, dramaturgu dhe studiuesi Sulejman Mato reagon i indinjuar: "Së pari, dua t'ju them se jo çdo person që vargëzon quhet poet dhe jo çdo vargëzim quhet poezi. Së dyti, kur i etiketon këto vargëzime me epitete "perlë", "fantastike", "antologjike", e të

tjera si këto, unë mendoj se ju tregojnë hipokritë me miqtë, ndërkohë që vargëzuesit ua kthejnë lajkatimet me falënderime." Pazar lajkash. (Nuk ka më keq: kur të lyejnë me varak dhe ti kujton se je i veshur me ar?!). Tjetër të çmosh dhe tjetër të lavdërosh. Preç Zogaj, në një koment, nisur nga eseja për poeteshën nga Uzbekistani, Xosiyat Rustamova, sigurisht dhe nga vetja, vë në dukje: "Ai, (dmth unë), lexon si pakkush brendinë e vargjeve dhe bëhet kështu një interpret që lartëson vlerën e tyre pa i zbuluar siç nuk janë." Zbukurimet janë lëvdata. Kur Nafija tundte dylbegun, s'po i binte ndonjë vegle muzikore. "Citimet vënë në provë shijet e eseistit. Aty kuptohet nëse po lavdëron e po ekzaltohet "për zakon" apo vlerësimet e tij mbështeten në cilësinë e poezisë që po analizon."-vazhdon Zogaj komentin e tij. Në asnjë shkrim timin nuk gjeni pasthirrma të llojit: e mrekuallueshme, gjeniale, e nivelit evropian apo botëror, e të tjera si këto, që shpenzohen pa hesap në komente apo në shkrime ekzaltuese. (Edhe në politikë retorikat nuk merren seriozisht.) Në

promovimet që bënim dikur, më kujtohet një ekspert, i cili, kur donte t'i ngrinte në qiell të preferuarit e tij, e niste diskutimin nësoj: "Poeti na ka sjell një buqetë me lule të freskëta." Në fakt, sikur i mallkonte se asnjë prej tyre nuk lulëzoi.

Dikur me kërkesën tim i shkrova parathënien librit poetik të një mikut tim. Pas botimit të librit, na bashkohet dhe një i tretë. "Si t' u duk parathënia e Bardhit?" Më bëri përshtypje, që, miku nuk po i kërkonte mendim për librin e tij, po për parathënien time. Në fakt, duke njohur tipin e tjetrit, nuk e kishte menduar keq. "Ai, duhet ta kishte thënë aty, që ti je poet botëror!" I tha fjalët me një autoritet të tillë, sikur "ai", të mos isha unë. Miku pa nga unë, duke mos e fshehur pakënaqësinë. Pas 5 vitesh, shoh parathënien të botuar në një gazetë. Me të rënë zilja e celularit e mora me mend, që do të ishte ai. "Ke parë ti, që më pëlqeu dhe e çova për botim!", "Duhet të prisje 5 vjet, që ta pëlqej?! Prit dhe nja 5 të tjerë, mbase do të pëlqej edhe më shumë.", "Lëre, lëre ma prishi mendja me atë, botërorin!" Historia u mbyll me të qeshur,

sikurse ndodh shpesh kur ndahemi me të shkuarën. (Edhe dinozaurët fluturonin.) "Lëvdatat shpesh e kanë brenda paramendimin"-thotë Konica, duke lënë të kuptohet, se tallashi shpesh merret për barut. Kush përkundet në ninulla fjalësh, do këndellet si një pallua në ekstazë, duke iu ngritur pëndët, tallet Konica. Së bashku me esenë, mbarova së lexuari dhe "Alkimistin" e Paulo Coelho, romani që i dha atij famë. Kur e botoi për herë të parë, përgjatë një viti, fillimisht u shit vetëm një kopje. Më pas edhe një kopje e dytë, blerë nga i njëjti person. Një person i dytë u kujtua ta blinte kopjen e tretë nga fundi i vitit, kujton shkrimtari në parathënie të librit. Trishtimi bëhet dhe më i madh, kur ky zhgënjim të vjen nga vendlindja. Në këtë rast Brazili. (Dy shtete ranë dakord të bënin një shkëmbim territori, ngaqë njëri kishte vetëm fushë dhe tjetri male e kodra me bollëk. Ata të ultësirës kërkuan një kodrinë në këmbim të fushës. Kur shkëmbimi u bë fakt, fusharakët u dyndën drejt kodrinës, edhe pse ishte një lartësi e huajtur.)

PSE MANIPULIMI?

Qysh moti dihet se fuqia e shpërblimit (për ndonjë sjellje të caktuar), është më efikase se sa fuqia e dënimit

Gjuro SHUSHNJIQ

Secila shoqëri disponon me mjetet (metodat) me anë të së cilave i sjell "në rend" anëtarët e vetë, nëse këta të fundit e rrënojnë "rendin dhe paqen" ekzistuese.

Mjeti i parë është dhuna e vrazhdë fizike apo forca e detyrimit. Të kontrolluarit e sjelljes me përdorimin e forcës fizike nuk është efikase, "sepse nëse e thyeni njeriun duke e munduar atë, ai do t'iu urrejë përgjithmonë" dhe do të përpiqet që ta ndryshojë gjendjen e vetë, duke mos bërë llogarinë se çfarë mjete do të përdorë dhe nuk do të bartë përgjegjësi për atë që është duke e bërë. Krahas kësaj, ai që ushtron dhunë (detyrim), gjithnjë ndjen frikë prej atij mbi të cilin ushtrohet dhunë. "Burgu nuk është asgjë. Burgu krijon vetëm urrejtje. Këtë do të duhej të kuptonin të gjithë armiqtë tanë". "Nëse do të ishte e mundur që egërsirën e fjetur te njeriu ta ndaloni duke e burgosur atë apo me dënimin në botën tjetër, gjithsesi - unë mendoj se emblema më e lartë e njerëzimit do të ishte cirku zbutës me shkopin goditës, e jo predikuesi që viktimizohet. Por, realiteti është në faktin se me shekuj njeriu nuk e ngrit mbi kafshët dhuna, por muzika dhe mospërballimi i së vërtetës, atraktiviteti i shembullit të saj. Vlerësohet se deri më sot, më të rëndësishme në Ungjill janë ato porosi dhe rregulla që janë përfshirë në urdhëresat; për mua më e rëndësishme është që Krishti flet prej rrëfimeve nga jeta, duke e ndriçuar të vërtetën me shembujt e përditshmërisë. Në bazën e këtij veprimi, mbështetet mendimi se familjarizimi midis të vdekurve është i pavdekshëm dhe se jeta është simbolike, sepse është e rëndësishme.

Qysh moti dihet se fuqia e shpërblimit (për ndonjë sjellje të caktuar), është më efikase se sa fuqia e dënimit. Sociologu më i shkëlqyer midis shkrimtarëve dhe shkrintari më i shkëlqyer midis sociologëve, Balzaku, për këtë shkruan: "Secili pushtet përpiqet që të mbahet. Që qeveritë të rrojnë, sot sikur që ishte dikur, duhet që t'i pranojnë në vallet e tyre njerëzit e fuqishëm, duke i marrë ata gjithkund ku ndodhen, me qëllim që nga ata të krijojnë për vete mbrojtës dhe që me anë të tyre t'ua marrin turmave ndjenjat dhe guximin që i nxisin ata për t'u revoltuar...Shteti i përshpejton revolucionet". Ai që është shpërblyer, ndjen falënderim ndaj atij që e ka shpërblyer, ai ndjen përgjegjësi që në të ardhmen sjellja e tij në afat të gjatë kohor t'i kënaq pritjet dhe përkushtimin e shpërbljesit.

Mjeti i tretë i fuqishëm me anë të të cilit kontrollohet sjellja e pjesëtarëve të shoqërisë, janë normat shoqërore - qoftë në formë të ligjit (normat juridike) apo në formën e formave morale (imperativet morale), urdhrat fetare (dhjetë urdhëresat e Zotit) ose udhëzimeve ideologjike, apo thjesht e normave zakonore. Për aq sa norma zakonore, morale, juridike, religjioze apo ideologjike, është karakteristikë e grupit dhe derisa anëtarët e atij grupi i përmbahen asaj, e vlerësojnë dhe e përjetojnë atë normë si të tyre, ajo shërben si mënyrë e prituri, bile edhe si mënyrë ideale e sjelljes për të gjithë anëtarët e

besimit në pagabueshmërinë e prijësit. "Autoriteti karizmatik, është një nga fuqitë e mëdha revolucionare të historisë, por në formën e pastër ai ka karakter plotësisht autoritar dhe zotërues."

Për ne, e rëndësishë së veçantë është fuqia mbi mendimin apo teknika e sundimit me anë të përdorimit të simbolit (idesë). Përpjekja që sjelljet e individit apo grupit të kontrollohen nëpërmes manipulimit të shkathët me anë të simboleve (ideve) shënon kthesë në metodat e sundimit në këtë kuptim, ngase metodat e vrazhda të detyrimit zëvendësohen me teknikat e buta të bindjes. "Heq

het); e) ndarje e punës dhe specializimi i pengojnë individët që edhe ashtu të arrijnë ta kuptojnë gjithë atë që është duke ndodhur me shoqërinë civile, prandaj janë të detyruar që këtë pamje të shoqërisë ta marrin prej atyre që në fakt ua ofrojnë këtë pamje; f) manipulimi nuk është formë e institucionalizuar e sundimit dhe për atë ai që e ka këtë fuqi nuk duhet të thotë, se si do ta përdorë, kur dhe për çfarë qëllimesh do ta përdorë, kështu që për qytetarët qëllimi i vërtetë ngelet i panjohur.

Vështrimi fluturimthi i tipave të kontrollit social, tregon se janë duke u ndryshuar format e kontrollit, që i praktikojnë grupet e fuqishme të interesit në shoqëri, por kontrollet nuk vdesin. Kontrolli bëhet më pak i dukshëm, por jo edhe më pak i fuqishëm.

Ne nuk mund ta dimë thjeshtë se a manipulon dikush apo jo derisa nuk e kuptojmë se çka nënkuptohet me shprehjen e manipulimit. Për këtë shkak, do t'i përmendim elementet përkatëse të konceptit të manipulimit dhe në bazë të tyre do ta ofrojmë definicionin e qartë teorik dhe empirik të nocionit të përdorur të shprehjes. Elementet bazë të shprehjes (që njëherit e përbëjnë strukturën bazë të këtij punimi) janë: - manipuluesi (burimi i mesazhit, dërguesi i mesazhit), - mesazhet që dërgohen në masë (përmbajtja, forma, koha), - turma me të cilën manipulohet (pranuesi i mesazhit), - kushtet socio-psikologjike në të cilat kumtohet mesazhi, - mjetet teknike, nëpërmjet të cilave transmetohet mesazhi, - çështje publike me të cilin ka të bëjë mesazhi, - për problemin nuk ekziston pajtueshmëria e përgjithshme, - por ekziston interesimi për mesazhe (motivimi), - pasojat që i shkakton mesazhi.

Prej kësaj buron përkufizimi: Manipulimi mund të definohet si veprim i paramenduar, veprim sistematik dhe i kontrolluar, apo si një mori veprimesh me ndihmën e të cilave manipuluesi, duke u shërbyer me mjete simbolike, në kushte të përshtatshme psiko-sociale për atë, dërgon në turmë, përmes mjeteve të komunikimit, mesazhe të caktuara, me qëllim që të ndikojë në bindjet, qëndrimet dhe sjelljet e një numri të madh të njerëzve, në mënyrë që ata, rreth çështjeve për të cilat nuk ka pajtim të përgjithshëm, dhe për të cilat çështje ata janë të interesuar jetësisht, do t'i orientojë drejt bindjes, qëndrimeve dhe vlerave të manipuluesit, dhe që për këtë veprim ata fare të mos jenë të vetëdijshëm.

Nëse krahasohet ky përcaktim i manipulimit (si formë socio-ekonomike e komunikimit)



grupit (shoqërisë). Normat juridike, morale dhe religjioze, internacionalizohen bashkë me kohën. Kjo do të thotë që sjellja me kohë bëhet e pavarur prej prezencës së drejtpërdrejtë të autoritetit të normave ose individit, të cilët e kontrollojnë nënshkrimin ndaj normave. Brenda e kontrollit nuk do të thotë zhbërja e kontrollit, por transferimi i saj nga rrethanat e jashtme në brendinë e vetëdijes, ku kontrolli tashmë është më pak i dukshëm, por jo edhe më pak efikas. Por, shumica ngelet e vetëdijshme për fuqinë represive të normës.

Historia politike dhe ushtarake është përplot shembuj të fuqisë karizmatike. Kjo është fuqia që ndonjë personalitet i veçantë e ka mbi turmën - pavarësisht faktit se a ka ai personalitet veti të prijësit të veçantë apo turma beson se ai i ka ato - dhe kjo fuqi mbështetet në frikën irracionale të respektit dhe

dorë prej sundimit mbi trupat tuaj, por vetëm për atë që të sundoj me shpirtrat tuaj". Asgjë nuk ka më të marrë se sa të ngadhënjesh; lavdi e vërtetë është që të bindësh." "Sepse pushteti dhe mbikëqyrja është në fjalë, e jo në duar. A ke diçka për të thënë apo për të dhënë, ndonjë vërejtje për mendimet e mia?"

Ajo çka e dallon manipulimin prej metodave të njohura historike të kontrollimit të sjelljeve është: a) se manipulimi është "bindje pa shkaktuar dhimbje", për të cilën njerëzit nuk janë të vetëdijshëm, sepse nuk e ndjejnë detyrimin b) manipulimi mbështetet në studimin shkencor të njeriut, c) janë të zgjeruara dimensionet e sundimit (mediet masive), d) varësia e individit prej organizatave të fuqishme dhe nga institucionet të cilat kanë monopol mbi informacionet, është brengosëse (dhe kush është i varur me atë, është lehtë të manipulo-

Sprovë

tanimë me formulën klasike të Lasvelovit "who says what in which channel to whom with what effect", menjëherë do ta shihet se formula Lasvelovit megjithëse e potencon burimin e mesazhit, përmbajtjen e mesazhit, mjetet për të përcjellë mesazhin, pranuesin e mesazhit si dhe efektin që e shkakton mesazhi, por në të njëjtën kohë neglizhohen kushtet sociale-psikologjike në të cilën mesazhi bëhet publik, synimet e dërguesit të mesazhit, problemin me të cilin ka të bëjë mesazhi dhe motivimin për mesazhet.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm midis përcaktimit të ofruar për manipulimin dhe shumicës së definicioneve që teoricienët e komunikimit i kanë ofruar, përbëhet nga fakti se shumica e tyre i kushtojnë më tepër kujdes këtij apo atij elementi të nocionit – disa e potencojnë rëndësinë e burimit të mesazhit, të tjerët formën dhe përmbajtjen e masazhit, të tretët i potencojnë mjetet teknike, të katërtit pranuesin e mesazhit, të pestit i potencojnë efektet e mesazhit, të gjashtit rrethanat në të cilat mesazhi bëhet publik – derisa përkufizimi i ofruar nuk i kushton ndonjë vëmendje të veçantë cilitdo element të shprehjes, por i sjell ata në raporte midis vetvetes, me analizën e të cilëve elemente zbulohet thelbi i nocionit të manipulimit.

Marrëdhëniet e zakonshme midis elementeve që i përmban përkufizimi ofruar i manipulimit, në të vërtetë e përbëjnë teorinë e manipulimit. Për shembull: ekziston lidhja e zakonshme ndërmjet autoritetit të manipuluesit dhe efektit të mesazhit të tij, midis efektit të mesazhit dhe rrethanave social-psikologjike, në të cilat mesazhi bëhet publik, midis mjetit teknik dhe efikasitetit të mesazhit, midis vetive të turmës (personalitetit) dhe efikasitetit të mesazhit.

Dhe e treta, dispozita e ofruar e manipulimit çon në atë, se për manipulimin nuk do të ketë qasje nga këndvështrimi i cilësdo disiplinë shkencore – siç është i shpeshtë rasti – sepse, "brenda kufijve të çdo discipline të veçantë në fushën e shkencave shoqërore, lënda e trajtuar shkapërderdhet". E vërteta është tërësia. Në ndarjen shkencore të punës, është thyer tërësia. Nga këndvështrimi i cilësdo shkencë, nuk është e mundur njohja e tërësisë apo së vërtetë. Prandaj, të kuptuarit e kësaj që pason, kërkon nga lexuesi të paktën të njohurit e koncepteve bazë të filozofisë, sociologjisë (veçanërisht sociologjisë së dijes, sociologjinë e gjuhës dhe sociologjinë e komunikimit masiv), psikologjisë sociale, psiko-analizës, por edhe të shkencave politike.

(Shkëputur nga libri **PESH-KATARËT E SHPIRTRAVE NJERËZORË**, botoi Logos A – Shkup, përktheu nga serbishtja Skender Latifi)

FORMA

Në studimin Historia e gjashtë nocioneve, studiuesi Wladyslav Tatarkiewicz, përcakton disa paradigma të formës estetike



Afrim REXHEPI

Historia e estetikës dallon disa paradigma të formës të cilat janë esenciale në definimin dhe të kuptuarit e veprës artistike. Në studimin Historia e gjashtë nocioneve, studiuesi Wladyslav Tatarkiewicz, përcakton disa paradigma të formës estetike. Në tekst i përcaktojmë edhe dy paradigma të tjera të formës estetike, siç janë: forma e hapur ose non finito forma dhe loja si formë estetike. Forma është sistem i elementeve në tërësinë e vet; Forma i është dhënë shqisave për t'u shijuar; Forma është kontura apo përkufizimi i objektit; Forma është formë substanciale; Forma është gjykim i arsyes së pastër ndaj objektit; Forma është shprehje e funksionit; Forma është shprehje e shpirtërores; Format e paradhënia dhe formëzimi i tyre; Format e përhershme; Forma dhe variantet e formës; Forma është element shpirtëror i veprës artistike; Forma është konvencionale; Forma është interpretim psikologjik; Forma e përshkallëzuar; Finito dhe non finito

forma dhe Loja si formë estetike. Interpretimi psikologjik i formës estetike pikëfillimin e vet e ka në teorinë për metodat eksperimentale të studimit, të shfaqura kah fundi i shek. 19. Metodat eksperimentale të Viliem Fehner dhe V. Vunt, aludonin që fenomenet a objektet në kohë – hapësirë të studiohen jo nga e përgjithshnjia apo abstraktja (sistemet teorike të Hegelit, Kantit, Shilerit), por nga gjërat konkrete me të cilat mund të eksperimentojmë. Në kontekst të kësaj, estetika si disiplinë humanistike, varësisht nga metodat e studimit: konkrete apo abstrakte, u nda në: estetikë "e lartë" që merrej me çështje metafizike dhe universale dhe estetikë "e ulët" që merrej me studimet e gjërave konkrete e reale. Duke e definuar estetikën e cila zhvillohej përmes eksperimentit, Fehner definoi tri metoda eksperimentale në interpretimin psikologjik të formës: metoda e selektimit të elementeve që e përbëjnë formën; metoda e konstruksionit apo e lidhjes së elementeve në tërësi dhe metoda e perceptimit psikik të formës. Pra, sipas

geshtalt – teorisë, formën e interpretojmë në tërësinë e vet e jo përmes elementeve të veçuara. Organizimi perceptiv që ndodh në psikën tonë kur i vështrojmë elementet e lidhura njëra me tjetrën në tërësi, është thelbi i geshtalt – teorisë. Organizimi perceptiv realizohet përmes ngjashmërisë midis pikave (elementeve), selektimit të tyre, përsëritjes, afërsisë dhe lidhjes së tyre në një grup të vetëm. Organizimi perceptiv krijon formën, edhe pse mungojnë disa elemente të formës. Përmes psikës e perceptojmë formën edhe pse formës i mungojnë disa elemente. Geshtaltistët, më parë nuk i perceptojnë elementet e pastaj formën, ata më parë e perceptojnë formën, ngjashëm me melodinë të cilën e dëgjojmë si formë e nuk i dëgjojmë elementet e kompozimit. Një observim i tillë teorik, i shfaqur midis dy luftërave botërore, u bë pikë qendrore kaluese e formës teorike e definuar si "psikologji e formës" ose si "konfigurim" / geshtalt - teoria. Geshtalt – teoria ka gjetur zbatim të duhur në teorinë estetike nga Rudolf Arnhajm. Geshtalt – teorinë e tij, Rudolf Arnhajm e zbatoi në artet pamore. Sipas tij, "perceptimi nuk është përjetim mekanik i elementeve, por konceptualizim i strukturave kuptimore" (Arnhajm, 1962: 85).

Sipas Rudolf Arnhajm, perceptimi dinamik është thelbi i përvojës estetike. Arnhajm zhvilloi idenë që perceptimi vizual përbëhet nga përjetimi i forcave vizuale dhe se përjetimi nuk është vetëm përjetim direkt i elementeve të gjetura në fushën vizuale, por është vetëdije e disa kualiteteve dinamike që shprehen në vepër. Format e gatshme të cilat mund t'i definojmë e t'i perceptojmë, nuk ekzistojnë. Është i nevojshëm interpretimi konstruktiv, pra aktiv i formave që dalin nga realiteti fizik. Sipas Ernst Kasirer, nuk duhet pranuar fakti që format janë materie të vulosura në vetëdijen tonë, përkundrazi format duhet të prodhohen përmes procesit të semiozës, përmes interpretimit të kuptimeve që dalin nga realiteti fizik. Interpretimi i kuptimeve nga realiteti fizik mundëson krijimin e formave simbolike, siç janë: miti, religjioni dhe arti. Në këtë kontekst, Kasirer pohon që arti është një formë e tillë simbolike që na mundëson ta vizualizojmë realitetin fizik, ta ndiejmë më thellë atë duke depërtuar në strukturat formale të saj.

"Ashtu siç ekziston thellësia konceptuale, ashtu ekziston edhe thellësia vizuale. E para zbulon dijen, e dyta artin. Dija apo njohuritë ndihmojnë ta njohim larminë e gjërave, kurse arti na mundëson ta shohim, ta ndiejmë larminë e formave" (Kasirer, 1978: 217).

GJITHMONË FLITET PËR DASHURI

Të gjithë joshen pas gjërave të bukura.
Përfytyrojnë një kopsht mahnitës, një jetë pa tallaze shpirti.
Endërrojnë të përjetshmen, por i tradhton përkohshmëria,

Gjithmonë flitet për dashuri, por të gjithë bëjnë prapështi,
kur i trallis koha-
m' tha gruaja e pikëlluar që rrinte e vetmuar në plazhin e kujtimeve.
Ajo rrezitej me lëkurën e ëmbël dhe nxirrte sekrete nga thellësitë e saj,
siç nxjerr zhytësi kristale vezulluese nga fundi i detit.

Kjo rrugë e gjatë përpara ka shumë hyrje dhe dalje.
Amulli. Hije. Tabela orientuese, ku fanepsen dritat e dëshiruara të fatit.
Të shpejta janë kthesat për dëshpërim dhe rrëshqitëse ato ka drejtësia.
Kur dalim nga tuneli rrëzohemi dhe ngatërrohemi në livadhet e shkreta.
Pastaj pendohemi.
Gjithmonë pendohemi për gjërat që s'i bëjnë.
Pendohemi edhe për gjërat që i bëjnë.
Shkruajmë kujtime për ditët e lumtura ose për mungesën e lumturisë.
Për mungesën e trishtë.
Zbrazëtisë.
Shtrëngatat.
Nostalgjinë.
Humnerën.
Unë s'di t'i përshkruaj rrugët e dashurisë,
por e di se në akullnajat e shpirtit
s'ka det më të trazuar se një zemër e lënduar.

SI DIKUR EDHE SOT

Ka njerëz që dergjen në ferr
bluhën nga politika
të tillë që udhëtojnë nëpër qiejt e hareshë
dhe të tillë që lidhen në litarin e pushtetit
e tërhiqen drejt botës së skëterrës.
Ka të tillë që presin para kontinentit të shpresës
dhe frikësohen t'i hapin portat e mbyllura.
Sepse frikësohen nga paqartësitë, të papriturat.
Unë pas kaq shumë vitesh bredhjesh
i shastisur shoh gjethet e mia vjeshtake
si duart e një dashurie përvëluese.

Po ç'bëhet me baltën tjetër,
atë të ndërgegjes së atyre
që kanë lidhë litarët e mashtrimit
dhe tërheqin zvarrë nga stina në stinë.
Ata që kanë mësuar artin e ulërimeve,
lavdi kërkuesit që kroatat si korba të zinj.
Ato korba i hanë gjethet e kësaj stine;
i hanë edhe sytë e kohës - O Zot!

"Kam etje"- tha Krishti para se të vdiste në kryq.
Por atij askush s'i dha ujë.
Atij i dhanë helm.
Sa shumë helm na japin,
përditë,
o Imzot!

SIMETRIA E GJËRAVE

Qielli është i mërziur.
I rrjedhin lotët curril si mua kur më shtrëngon mungesa.
Ti e di që mua s'më pëlqejnë hapësirat ndërmjet gjërave që s'puqen.
Ndaj, më duhet t'i pagëzoj dëshirat e trazuar që çohen peshë
si malet kur uturinë qielli dhe pastaj të pushoj në pluskat e erës
si dora e dashur si terplote qetëson dallgë shpirti.

Përditë duhet të mësoj simetrinë e gjërave,
ecjen tënde ka qëllimi pa prekë nëpër valët e këtij oqeani pa formë.
Kam njëmijë arsye shtesë për të bërë një shtegtim nate,
edhe nëse mungon drita, udhërrëfimi, momenti.
Ndoshta gjithçka i përket tanimë së shkuarës.

Pranë syve të tu të njomë rri pema
që ti e do më shumë se çdo gjë.
Ajo pema e kujtimeve fëmijërore,
plot formula magjike,
si bredh i bukur Krishtlindjesh.
Ajo pema që të bën hije dhe t'i lidhë
ndjenjat e shpërndara nëpër flluska stinësh.
Nëpër erën e luleve. Të kuqtë e qershive.
Akullin e shpirtit. Lulet e pranverës.

Dimri këndeje është i rëndë dhe bie borë e madhe.
Bie borë edhe në shpirtin tim
sa herë më mungon ngrohtësia jote,
ajo muzika e përhershme,
egërsohet diçka dhe i mbyllet pemët e mia
siç bën stuhia dimërore në pranverën e vonë.

MOS U MËRZIT ME KËTË MJEGULL

Që vërtitet nëpër qiell tash e sa kohë,
si i hutuari që humb rrugë në një pyll
të trazuar ndjenjash dhe s'di kah ia mban.

Pa shtigje është koha, pa shtigje jemi unë e ti.
Vijmë dhe s'dimë kah shkojmë.
Në këtë zbrazëti ku krijohen mirazhe paqartësi që s'i dua.
Jo, s'i do as ti.
Është mjegull, por ti s'duhet të mërziqesh.
Gjërat do të ndryshojnë
dhe faqet e zezë të këtij libri do të kalohen.
Edhe pylli do të pastrohet
dhe ne do të ecim dorë për dorë e të gëzuar si kurrë më parë.

Në gishtat mund të mbetet ndonjë njollë,
por shiu i pastrimit do të bjerë shpejt
dhe mund të shlyejë gjithçka që duket.

Por çka të bëj me ato që s'duken - thashë
dhe të këqyra në sy të ëmbël ku zbutet pezmi im,
dhe përnjëherë hapen shtigje, siç hapet qielli kur davariten retë.

Ku të arratisem unë?
E mbaj veten si fëmijën e porsa mësuar me hapat e parë të jetës.
Më duhet ta shtrëngo,
të mos enden ndjenjat e mia si re të zezë në këtë shtegtim nate.

Trupi im është i lodhur nga bredhja.
Më duket vetja si ai burri në rrëfimet e biblike
që donte të hynte në tokën e premtuar
dhe të fillonte rrëfimin e ri.

Kah t'ia mbaj në këtë stinë zbrazëti,
kur rrugët ndahen si hija e mendimeve
në një mëngjes amorf.

ORËT E VONA TË PRITJES

Gjërat e bukura ndodhin rrallë,
pas një shtrëngate, orëve të vona të pritjes,
kur vetja të duket hije në një tunel pafund
rrethuar me erë dhe pasiguri.

Me vete bart një mori ndjenjash të trazuar
dhe si ushtar i kthyer prej një beteje të gjatë,
ec i shoqëruar nga ndërdyshjet,
psherëtimat,
shkujdesja dhe pritja.

E kur të pushojë stuhia, shikon kupën qiellore
si një udhë pa krye dhe rënkton.

Të duhet ta kuptosh nëse ke pësuar disfatë apo ke korrë fitore.
Ndonëse humbjet s'të pëlqejnë, ato të ndjekin si hija.
Të shoqërojnë në orët e vona të natës,
kur i mbyll dritaret e ëndrrave dhe sheh përpara pyllin e zi.

Ti e vendosur si kurrë më parë u ngjeshe pas meje
dhe unë ndjeva aromën dehëse të gjoksit tënd.
Atëherë fjalët rrodhën nga goja jote
si uji i mëshirshëm nga një kua i moçëm
ku unë shërohesha nga dridhjet,
etja,
nostalgjia,
marramendja.

Në librin e jetës të gjithë duan të jenë fitues.

Mesnatë.
Yjet shkëlqejnë
dhe unë djeg fletët e shkruara me babëzi për lavdi të rreme.

VERDH'SI

Si hyne n'konakun e shpirtit tem
n'ofshamë
n'kaçuba t'shpirtit si mrrive
shpalue sall' n'dite zie
per me ni fjalen
t'kputun si fije bari
t'mytun si za i larg't
si hyne n'konakun tem
kodrave t'shpirtit, si mrrive
me e pa anrren e fikun
e driten e shkimun
si hyne n'konakun tem
n'konakun tem si mrrive
me ni zanin
skutave t'shpirtit
si hyne
me i ngja rrajve t'lisit
verdh'si.

EMNI

M' thuej,
dera jem
a asht' der'e bab's,
a asht' der' e yte?!
M' thuej,
loja jote, loja jem a asht'?!
M' thuej,
syt' e mi, a jane syt'e mi,
a jane
te tut' sy?!
M' thuej,
qeshja jem, a asht' qeshja jote?!
M' thuej,
dhimta jem
vec e jemja asht'
M' thuej,
emni, e emni
a asht' vec i jemi, em'n'?!
...

LISI

Tash në k'te mjes t'mujtun
as veten s'pe marr' vesh
e gjevap s'deshta me i dhan' rrenave
naltësive t'papame m'sy u' kam
sall me pa veten ku ngjitet trup'jemi
shum' do degë i theva
tuj m'shtërngu do t'huj
paj mos me pa ditën
veç mbrri kom diqysh,
kah nis me praru dielli.

BAB'E BIJ'

si me diftue per vedi
e mledhun e krrusun sihariq per ta
sa e sa here cakrrue shpyrtin
e qyren te'tan jeten
me bisht e pa bisht o bab'
e une tuj' shpalue 'anrrat e mia t'mdha
trasue nga ti
rueza rueza udha jem e madhe
e qe
per dashnin e tokes, toke u bana
shkel m'kane te'tane bab'
n'ket boten tane, n'ket' mjedis t'mujtun
...tash le' jam per s'dytsh
e nisa me ec bab', pasha buken'
kam me ec o bab'...

ME DASHT'

t'ut pam ty kam nis me dasht dhe dekën
e mu ngi në lumni niherë e përgjithmonë
me kriju anrren si asht me shpërthy
me pas ni temel tonë
me marre hovin si hava dikur
që mekatnoi n'ambëlsi
me u mbyt n'robni me lëshue lirshëm vetën
sa me pa idhnin n'ambelsi rinore
e me dasht krejt mnershëm
në fronin e një grueje qe vec ajo di.

TRANZI(T)CION

deshta me i fol vetmise si shoqja - shoqes
me i shtrysh langshem kujtimet tona
me i thane sa gat' eca dej sa erdha n'logun tan
se pa dashtun me percillshin do hiena
e hapin ma ngatrojshin
po dridhshëm me tradhtoi e shkreta
se dy u bam' pej motit.

MALL PËR VJETIN E RI

me plot dhimt e vnerë
dashni e harresë
kercnime e sharje n' t kapercyem
po i mshel syte ky vjet
veç hareshem po m'pushton ma t'mramen dit' t'tijen
sa me'm lan marak për t' shkuemën
mem than' se ktu jam
drithnueshme pom shkun
mnershem ec n'vijen q'njekas po zhduket
e mallshem po m'kap flokun si borë e bardhë
hetueshem po ngjitet n'maje
ku rri babagjyshi plak me drenushat
...e dini?
ai babadimni q' androrojshim dikur.

SH'PIA

ika krejt kthjellu menimi
në pikën e shpirtit të çoroditun
kur erdh mërzia tekanjoze
plotë elegancë e përdredhun
si prostitutë bordeleje
befas ta ban ftyrën për i 'pare
bash qysh duen bubreecat
aty n'zgavrën e derës s'hymjes
e unë
as n'tokë
as n'qiell
me shpirtin e futur në një trup
sharrue deri n'fyt
me anrrat e përmbysuna udhëve t'gata
Ika krejt fikallivet
larg shpisë teme
me botën para meje.

NËN MOLLË (PO) RRINTE VASHA



Bajram SEFAJ

Jo si vasha e A. Pashkut, që rrinte nën qarr.

Jo!

Vasha e tregimit, e ëndrrës katile e shtrembalaqit, rrinte nën hijen e një peme frutore. Nën hije molle!

Dhe, nuk i kullose, as nuk ruante delet, si vasha nën hijen e qarrit, të A. Pashkut.

Kjo e shtrembalaqit, nën hije molle, në bahçe, m'as sh'pie, ruante lëngatën e vet, që, kushedi ç'prej kohe, në tërë fshatin bridrinas, i kishte dalë zëri se kish firuar, se ishte hallakatur, ishte çmendur dhe ishte derdhur krejt nga mendja.

E ç'rrembhuqjeje e kishte katandisur të mjerën?

Enigma kishte ngelur si grykë e hapur e një shpelle memece, që, sekush, sipas dëshirës, gjykimit dhe hamendjes së lirë, hidhte gjithfarë fjalësh, trillimesh, cungash, leckash, herë-herë shpotitëse, që assesi nuk arrinin t'ia gjenin fundin asaj grope, e lëre më ta mbushnin, sa e pafund kishte qëlluar ajo!

Shtrembalaqi nuk kishte kaluar andejpari me punë, as me vetëdije. Kishte pikur aty, nga një palë e panjohur qielli.

Derisa kalonte pranë saj, bënte një grimë kohe e ngrysur, e përzishme. Askush nuk mund i binte në fije se ç'pjesë dite, në mos nate, ishte ajo kohë hibride.

Memecërisë së vashës, ulur galiç nën mollë, sakaq i ishte prishur terezia.

I ishte ngacmuar lëngata, keq. Si të

ishte gjendur para një rreziku të tmerrshëm, ajo kishte nxjerrë përpara krahët. Kishte shtrirë duart e dridhura, që i përfundonin me gishtërinj të prerë, si të brejtur gangrene dhe të rrafshuar e të tretur në «mollën» e shuplakës. Bashkë me marrjen e qëndrimit mbrojtës (gard), kishte lëshuar një klithmë jo gjithaq të zëshme, por të thellë, brenda vetes, plot kërcënim.

Në duart e shtrembalaqit, se nga ishte shfaqur një majë thike flakëvërdhë, sa katilleshë që kishte qëlluar e pista, ajo.

Në fytyrën e tij, si me zor, duhej të sajohet një nënqeshje e murrme. Por, as nënqeshja, as fjalët e mbytura në të: «nuk e di e gjora se do ta godasë!», nuk kishin arritur t'i gufonin zgorit.

Më parë së fjalët, më parë së çdo gjë tjetër, kishte ngjarë goditja. Dy herë nga dy të prera të holla zehër. Ai kishte qëlluar fytyrën e zbehtë nur, të vashës!

Një herë teposhtë, një herë përpjetë! Dy herë.

Poshtë e lart.

Vasha kishte lëshuar një klithmë të paartikuluar. Lëmeritëse, deri në kupë të qiellit.

Katër herë, në fakt, e kishte qëlluar.

Me të dyja duart kishte zënë dy gropat e syve të përgjakur!

- Po ti, më verbove dy sysh, o njëri i lig!

- Më verbove për mot e jetë! - kishte nxjerrë britmë të qartë e çuditërisht të kthjellët.

Kishte shqiptuar ato fjalë aq qartë, aq pastër, saqë, bëje bë se kurrë nuk kishte lënguar, as nuk lëngonte, nga

asnjë sëmundje e ligë, nga ato për të cilat supozohej se dergjej shpirti i saj.

Fjalët e saj kishin jehuar thellë e kishin dalë si të ruajtura enkas për atë çast të lig, si ky.

Nga dridhmat dhe ethet e tmerrit, shtrembalaqit veç sa s'i kishte pikur në tokë tehu helmues i thikës.

Në atë çast të mjerë, sa fatlum dhe shpëtimtar atij i ishte shfaqur figurë e mishtë e një luqerbulli, a e ndonjë shtaze tjetër të llojit të tij, shumë më e llahtarshme, por që, sasi e madhe tuli, zbuste egërsinë e tij dhe e bënte më pak të rrezikshëm, se që i duhej çastit. Kur ai donte që, një shtazë tjetër, krejt tjetër, tepër të rrezikshme dhe tepër të egër, një tigër a luan, ta rrokte ndër kthetra fatkeqen e me nofulla të forta e dhëmbë të mprehtë që kafshojnë egërsisht, sakaq ta bënte atë copë e grimë dhe, me garbi tërbuese, të kollofiste grumbullin e trupit të saj kur gërmuq, e përgjakur dhe e verbuar dy sysh, rrinte nën hije molle.

Atëherë ai do të ishte i qetë. I lumtur që veprës së tij të ndyrë, do t'i zhdukeshin gjurmët. Përgjithmonë.

Mirëpo, shtaza e egër, që aty, në atë çast, e kishte sjellë një shteg i panjohur mbretërie malesh, nuk kishte bërë asgjë tjetër, veçse fatmjerës i kishte hedhur një vështrim të lehtë, aspak armiqësor dhe beftë ishte zhdukur në terrin (futë) të zi.

Ai kishte ngelur i zbrazët.

Para vetës kishte aktin mizor të kriminit dhe figurën e masakruar të viktimit të pafajshme!

Skenë kjo e vështirë. Më trishtuese se ato të filmave të horrorit të skajshëm, neveritës.

Shtrembalaqi ishte shkoqur kthet-rash të ëndrrës se keqe.

I bërë ibret djersësh të ftohta ethesh. Llogaria se shtaza e egër, do t'ia fshehte e fshinte gjurmët e këtij krimi mizor, që nga kjo katrahurë të dilte paq, i doli shterpë. Bosh. Huq.

Bashkë me kokrrizat e djersëve të ngrira, në zemër që i pulsonte si e çmendur, kishte ngelur vrugu i pashlyer, për mot e jetë: «e po kjo, njëmend, përnjëmend, nuk kishte asnjë kuptim! Një gjë e tillë nuk duhej të ndodhte, madje as në ëndërr kllapitëse. Një masakër. Një krim makabër, të cilin nuk do ta provonte as skenari i ëndrrës më të keqe, më ankthore, më të pabesë» - kishte bluar vetë me vete Shtrembalaqi dhe kishte shkundur mllefin, si për t'u shfaqësuar: «ani, thirri në vete, ashtu siç e meritoi edhe e gjeti ndëshkimi, pse nuk me kishte pritur, nën hije molle, me mollë besnikërie në gji, siç me kishte premtuar, kur, nën hije mollësh, thurnim ëndrra rinore, për jetë të lumtur, për ardhmëni!».

*

Ai kishte pirë një gotë ujë të ftohtë. Serishmi ishte shtrirë në shtrat.

Ishte kthyer në krahun tjetër dhe më frymëmarrje të lehtësuar, që asgjë e keqe nuk kishte ngjarë, në fakt.

Ishte orvatur të zinte fijet gram-shalesh të gjumit të prishur.

Çaponjtë e ëndrrës se keqe i ishin ngjitur për fyti. Në zemrën dhe shpirtin e tij të brishtë, kishin shartuar këtë kujtim katil.

(Paris, pranverë 2003)

IKONA E LETËRSISË PËR FËMIJË E TË RINJ

Librat e Adelina R. Mamaqit janë të jetueshëm. Kjo pasuri e vlefshme është dhurata më e bukur dhe fisnike që shkrimtarja nëpër vite i ka bërë Bibliotekës së Letërsisë për fëmijë dhe të rinj, dhe Kulturës shqipe

Xhahid BUSHATI

Adelina R. Mamaqit, edhe sot e kësaj dite, mbetet ikonë e Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. E ndërtoi profilin e saj prej artisteje si rrallëkush në fushën e letrave shqipe. Është modeli i vetëm prej shkrimtareje, që me talent e konsekuencë, - siç thotë një poet "... të kesh gjëra për të thënë...", ka rrezatuar fuqishëm me një "bum" botimesh, veçanërisht pas viteve '90. Ndërkohë, kritika letrare, ajo pak kritikë që kemi, foli për librat e saj shumë pak ose heshti. Atë që se bëri kritika letrare e studimet, e bënë lexuesit e vegjël, por edhe prindërit, gjyshërit dhe gjyshet e atyre lexuesve, që si çdo herë i mirëpritën librat e saj, i rrethuan me dashuritë e zemrave dhe thanë pafund fjalë shpirti, e fjalë urimi...

Librat e Adelina R. Mamaqit janë të jetueshëm. Kjo pasuri e vlefshme është dhurata më e bukur dhe fisnike që shkrimtarja nëpër vite i ka bërë Bibliotekës së Letërsisë për fëmijë dhe të rinj, dhe Kulturës shqipe. E gjej me vend të përsëris thënien e romancierit dhe akademikut francez Dominique Fernandez, i cili thotë: "Janë shkrimtarët ata që ndryshojnë botën." Mendoj, që duke parë kontributin e saj, shkrimtarja Adelina R. Mamaqit i meriton këto fjalë. Dhe kjo e vërtetë, përkon në këtë fundviti (2017) kur Qeveria i akordoi pensionin special. Duhet thënë, që pas viteve '90 është hera e parë që një shkrimtare e letrave shqipe për fëmijë e të rinj vlerësohet dhe nderohet kaq lavdishëm.

Emri i Adelina R. Mamaqit u shfaq në fushën e letrave shqipe aty nga fundi i viteve '50. Në agimin e viteve '60 botoi librin e parë poetik për të rritur me titull "Ëndrra vashërie". Atëherë ishte 16 vjeçe, dhe... çuditërisht libri fliste për dashurinë. (Koha dhe realiteti nuk e favorizonte.) Brishtësia poetike dhe intimiteti i shpirtit sikur... nuk plotësonin kërkesat e letërsisë së realizmit socialist. Ishin në kontradiktë. Ky "duel", më vonë, pati pasojat e veta tek udha e mëtejshme letrare e poetes.

Gjatë viteve të krijimtarisë, poezia për të rritur, papritur, do t'i shndërrohej në një ëndërr..., një ëndërr që do të përfundonte në sirtar. Ajo nuk do të rendte së kërkuari 'Ëndrën e vashërisë'. Gjithsesi libri në fjalë pati shumë jehonë në atë kohë. Më pas u botua edhe në Kosovë. Këtu pati dashamirësi, jetësim, mirënjohje, adhurim dhe jehonë. Aq sa, kur Adelina shkoi në "Mitingun e poezisë, në Gjakovë, më 1972, fjala e parë e mirë-sëardhjes ishte: "Na e mbushe Kosovën, me Adelina, moj burrneshë!" Si dëshmi e kësaj "Ëndrre..." Adelina R. Mamaqit u bë poetja e parë në letërsinë shqipe.

Vrojtimi im kësaj radhe fokusohet në kontributet e autores në fushën e letërsisë për fëmijë e të rinj. Pasi, aktualisht dhe në perspektivë për këtë letërsi, kërkohen studime në njohjen e vlerave të vërteta të saj. Kërkohet optikë e re vështrimi, veçanërisht në përcaktimin e vlerave jetëgjata, si fond i asaj periudhe, që u mbyll në vitet '90. Pastaj është periudha e ndërrimit të sistemeve. Pastaj, sa është e pranishme fryma e metoda e realizmit socialist i asaj

letërsie në krijimtarinë letrare pas viteve '90 tek krijuesit e kësaj letërsie, është një ftesë për diskutim dhe kërkim studim më vete.

Qasja me objektivitet ndaj vlerave (të atyre që u krijuan para '90-ës dhe të atyre që vazhdojnë të krijohen pas '90-ës), na shpjen në shumë dukuri, fenomene dhe tipologji të krijuara në marrëdhënie me kohërat e realitetit, të cilat na orientojnë për të parë sa më qartë udhën, mozaikun dhe zhvillimin e letërsisë për fëmijë e të rinj.

Shkrimtarja Adelina R. Mamaqit, i takon brezit të shkrimtarëve për fëmijë e të rinj të viteve '60. I takon një brezi

e personalitetit të brezit të ri." Më pas, dekadat e mëvonshme do të flasin se, kjo shkrimtare solli një krijimtari të pasur e të larmishme, krijimtari që vazhdon edhe sot. Kjo është arsyeja që për vlerat që bart e sjell (dhe në vazhdimësi...), shkrimtarja Adelina R. Mamaqit mbetet një ikonë e letërsisë për fëmijë e të rinj. I të njëjtit mendim është dhe studiuesi Prof. As. Dr. Astrit Bishqemi, i cili thotë: "Shkrimtarja dhe poetja e njohur Adelina Mamaqit, edhe sot e kësaj dite, vazhdon të ruajë postin e një përfaqësueseje të denjë të poezisë shqipe për fëmijë."

Lënda poetike që na ofron shkrim-

e Adelina R. Mamaqit. Ashtu siç kam ndjekur dhe ndjek në proces edhe mendimin kritik e studimor në lidhje me krijimtarinë e saj e të autorëve të tjerë të letërsisë për fëmijë e të rinj, të cilët edhe pse të pakët në numër, vazhdojnë të shkruajnë. Leximi i një veprë të një autori, aq më shumë disa vepra të tjera që janë të një gjinie a zhanri poetik, lexuesi, aq më shumë studiuesi, krahas përftesës së emocionit dhe kënaqësisë estetike, krijon marrëdhënie shumëplanëshe me të ose me to, e, po në këto rrafshë marrëdhëniesh bisedon e komunikon parreshtur... E kjo ndodh, sepse "është komunikim i ngritur në sistem: të përcjelljes e të dërgimit të mesazhit e të marrësit, receptuesit, dhe, ky sistem, sikur nënvizojnë njerëz të dijes që nga Barti e deri te Fuko; duhet të bëhet hallka kryesore e interpretimit, shpjegimit dhe komentimit të vlerave artistike." (Bloom, Harold) Kështu, të lexosh korpusin e veprave të një krijuesi, siç është në rastin tonë të Adelina R. Mamaqit do të thotë: *t'ia dhurosh thelbin e përmbajtjen estetike*, *raporti në mes veprës dhe lexuesit përpunohet, përsoset dhe bëhet i ngushtë e i afërt*, *statusi i veprës letrare qëndron në varësi nga mënyra e receptimit të tij*, *kurse shumësia e leximit shtrin rrjetën e tij tutje, me kuptimet që zgjon teksti i lexuar. (Bloom, Harold).

Gjatë vështrimit tonë në lëmin shkrimor e historik, herë pas here në periudha të ndryshme kohore kemi gjetur në disa shkrime e studime të botuara në organe të ndryshme, mendime e interpretime shpesh kontradiktore në lidhje me fillimet e sakta të jetës letrare të kësaj autoreje, pra në atë që e quajmë 'pikënisje' a etapë brenda biografisë së krijuesit. Përgjigjen e saktë të këtij problemi, realisht, na e ofrojnë libri: "Ëndrra vashërie" dhe krijimet letrare të kësaj autoreje botuar në periodikët e gazetave e të faqeve letrare të tyre, para se të botohej ky libër me poezi për të rritur. Kështu që ky diskutim, mendoj të quhet i mbyllur e të mos variohet me interpretime të pabukët.

Libri i parë me poezi për të rritur për vlerat që mbarte, për shumë 'tabu' që thyente e sfidonte zëri femëror i poetes, që në fillin e prezantuan denjësisht si krijuese të talentuar Adelina R. Mamaqin. Ndonëse, rrezatimin dhe jehonën më të madhe e pati më shumë në Kosovë se sa në Shqipëri. Me këtë libër poetik ajo hyri e sigurt e me dinjitet në botën e letrave shqipe.

Në marrëdhënie me kohën kur u botua ky libër dhe me lexuesin, më mirë se kushdo flet ky fragment vlerësimi, të cilin po e citojmë: "Në vitin 1963 (Adelina Mamaqit, nënvizimi im, - Xh. B.) e botoi librin me poezi për të rritur "Ëndrra vashërie", libri i parë i një poetes shqiptare, i cili bëri jehonë te lexuesit dhe te kritika, jo vetëm për vlerat artistike, por edhe për faktin se e theu një tabu: Kjo poete e re merite guximin t'i shprehte ndjenjat e dashurisë femërore, në një kohë kur fjala 'dashuri' ishte thujt një mëkat." (Gazeta "LAJM" (Kosovë), 26.10.2009, shkrimi: "Adelina Mamaqit në Kosovë, pas 40 vjetëve").

Shkodër, më 26.01.2023



me kontribute të rëndësishme e me risi, si: në problematikë e tematikë, vështrim, pasurim gjinësh e profilesh, ligjërim e rrëfim në letërsinë për fëmijë e të rinj. Ndaj me të drejtë Prof. as. Dr. Ramazan Cadri shprehet: "Vitet '60, që përbëjnë një etapë të re në jetën ekonomike-shoqërore të vendit, shënojnë një stad të rëndësishëm për procesin e formimit të plotë të letërsisë shqiptare për fëmijë, si letërsi me tipare ideore dhe artistike të përcaktuara. Shkrimtarë të ndryshëm, që ia kushtuan energjitë e veta krijuese kësaj fushe të letërsisë, ishin të vetëdijshëm për rolin e rëndësishëm të veprave letrare në edukimin ideoestetik dhe në formimin

tarja është e gjerë dhe nga pikëpamja tipologjike: e larmishme. Ajo të fton për shumë këndvështrime. Shqyrtimi i një aspekti, i formuluar në krye të këtij studimi, dhe i selektuar nga krijimtarja e gjerë dhe e larmishme poetike e Adelina R. Mamaqit, u bë shkas se i besova dhe u udhëhoqa nga një formulë filozofike-letrare, të cilën e kisha lexuar kohë më parë, e cila thotë: "Ndër librat që të interesojnë, qëmto ata syresh që ia vlejnë të shqyrtohen e të konsiderohen dhe që ju rrëmbejnë në botën e tyre, në të vetmen botë të pacenueshme nga tirania e kohës." (Bloom, Harold)

E kam ndjekur në proces krijimtarinë

PËRJETËSIA, NJOHJE INTUITIVE POETIKE E LASGUSH PORADECIT

(Njohja poetike e gjërave i përket poetit, kurse bashkimi merret me personalitetin e poetit)

Sulejman MEHAZI

Përjetësia kuptohet si problem i madh filozofik që ka të bëjë me kohën, me realitetin e botës së jashtme dhe të njohjes; mirëpo përjetësia zë dhe një kuptim dytësor, sepse nuk ka të bëjë aq me filozofinë, sesa me poezinë dhe teologjinë. Para se të themi se ç'është përjetësia do të shënojmë vargjet e para të poezisë "Përjetësija" të ciklit "Zemra e Përjetësisë":

Jam sot,
Si vjet,
Si mot,
Si përgjithënjë.
(Lasgush Poradeci, vepra I, "albPa-per", Tiranë, fq. 215.)

Sipas këtyre vargjeve vërehet se përjetësia nuk është vetëm e sotmja, përkundrazi, ajo është e të gjithave të djeshmeve tona, e gjithë e shkuara, ajo e shkuar që s'dihet se kur ka filluar dhe e gjithë e ardhmja mjaft e frikshme dhe e pasigurt. E ç'është përjetësia?

Përjetësia sipas poetit është kur në një çast bashkohen mrekullisht tri kohët kryesore në një. Plotini thotë: "Ekzistojnë tri kohë, e të tria janë të tashme", (Jorges Luis Borges, Pavdekësia dhe ligjërata të tjera, Tiranë, 2000.) "Jam sot" është e tashmja aktuale e përjetësisë, momenti në të cilën është duke folur poeti, "Si vjet", është e tashmja e së shkuarës, që mund të quhet kujtesë, dhe e tashmja e së ardhmes "Si mot" që mund të kuptohet si shpresë apo frikë poetike. "Si përgjithënjë" koha është imazhi i lëvizshëm i përjetësisë, që do me thënë se koha burimin dhe rrjedhjen e ka nga përjetësia, nga një qenie e përjetshme dhe kjo qenie e përjetshme më vonë do të projektohet në "trupin" fizik, në "zemër" që shijon dhe "shpirtin" e frymëzuar. Përjetësia kuptohet si rrjedhshmëri e vazhdueshme dhe e pakrahasueshme gjendjesh ku secila kohë paralajmëron atë që vjen dhe përmban atë që ka ikur. Asnjëra prej tri kohëve nuk mbaron, por ndërthuret me njëra tjetrën.

Kjo ndërthurje poetike ka për qëllim rrokjen, përkapjen dhe përjetimin e absolutes që është metafizikë e lashtë arketipe universale, e cila pranon realitetin e përjetësisë si esenciale për ekzistencën dhe është psikologji poetike e cila në trup, në zemër dhe në shpirt gjen diçka të ngjashme, po bile identike me realitetin e përjetësisë.

"Në trup jam,
Në zemër' e shpirtin t'ënd."

Po të krahasojmë mënyrat e ndryshme të përkufizimit të trupit real dhe konceptimit të përjetësisë, gjegjësisht të pavdekshmërisë, do të hasim dy mënyra të njohjes. E para,



është ardhja dhe hyrja e përjetësisë në trup, në zemër dhe shpirt:

"Kur jam në trupin t'ënd,
Jam domosdo
Kur jam në zemër t'ënde,
Jam vetiu
Kur jam në shpirtin t'ënd
Jam domosdo"

Kurse e dyta, dalja e përjetësisë nga trupi, zemra dhe shpirti:

"Dhe jashta trupit t'ënd prej vetvetiu:"; Dhe jashtë zemrës s'ate domosdo:
Dhe jashtë shpirtit t'ënd prej vetvetiu:"

E para, varet nga këndvështrimi i simboleve të përdorura siç janë: trupi, zemra dhe shpirti, ndërsa e dyta, nuk varet nga asnjë këndvështrim dhe nuk mbështetet në simbole të caktuara. Këndvështrimi i parë poetik përbën frymën poetike filozofike, të paraqitura në historinë e mendimit filozofik dhe është relative, gjersa këndvështrimi i dytë përbën trashëgimin poetike të gjithëmbarshme metafizike, "Jam domosdo", "Jam vetiu".

Përjetësia për poetin në fillim është "Lëndë-e thjeshtë, lënd' ujem", është rrjedhshmëri e vazhdueshme dhe e pakrahasueshme gjendjesh ku secila paralajmëron atë që vjen dhe përmban atë që ka ikur. Asnjëra prej tyre nuk fillon dhe nuk mbaron, por të ndërthura dhe të ndërthurura njëra me tjetrën sipas rrjedhës së vendit (hapësirës) dhe kohës:

"Marr të rëndët që përdhe.
Marr të fellët nënë dhe.
Po që Lart prej Qënies vetë
Marr e jap përjetësi"

Këto vargje kanë për qëllim rrokjen dhe përjetimin e absolutes dhe është metafizikë e lashtë dhe universale e cila pranon përjetësinë. Për Lasgush Poradecin është etikë dhe estetikë e artit poetik, që si cak të fundit paraqet pranimin e një realiteti imanent dhe transcendent që është emërtuar "Për-

jetësia".

Përjetësia është botë harmonike e arketipe, sepse këtë poeti e shpreh me anë të "Lënda dhe Jeta", "Fryma dhe qëllimi", "Ndjenja dhe Njeriu" dhe "Njeriu dhe Zoti". Përjetësia te Lasgush Poradeci manifestohet si tërësi universale, kulturore, poetike ose thënë ndryshe si vlerë ontologjike, etike dhe estetike. Realiteti poetik i përjetësisë për poetin bëhet më i rëndësishëm kur depërton më thellë në ekzistencën dhe zhvillimin e njeriut si dhe në ngritjen e evoluimit të vetëdijes.

Në realitet këto përmasa janë aspekte të kozmosit dhe aspekte të vet qenies së poetit, prandaj edhe bën harmonizimin e tyre mes vete. Pas harmonizimit vihet deri te pëlqimi, dhe në fund te bashkimi (shkrirja), gjegjësisht, gjendet në përqafim të simpatisë kozmike si rezultat i vetëdijes kozmike. Lasgush Poradeci me anë të poezisë "Përjetësija" shpreh prirjen më të lartë të njohjes së jetës prej së cilës burojnë veprat e vërteta të artit, poezisë e filozofisë. Këtë njohje të lartë e zbulon me anë të vullnetit dhe njohjes intuitive.

Njohja intuitive dhe frymëzimi intuitiv ndryshon dukshëm nga njohja e talentit, sepse talenti poetik mendon më shpejt e më saktësisht se të tjerët, ndërsa poeti me anë të intuitës kap një botë të ndryshme nga ajo e poetëve të tjerë, sepse ai vërteton më thellësisht se të tjerët dhe përjetësia në mendjen e tij paraqitet në mënyrë më objektive, më e pastër dhe më e qartë. Me anë të këtij cikli të "Përjetësisë" poeti kupton se krijimi i tij do të ekzistojë vetëm me ndihmën e përjetësisë. Në këtë nivel të gjitha krijimet konsiderohen si reflektime dhe shenja të përjetësisë, këtë e shpreh në vargjet në vijim:

"Në mal, që mëndjen ty t'a çqetëson,
Në hon, që mëndjen ty t'a turbullon,
Në det, që mëndjen ty t'a laftaron,
Në qjell, që mëndjen ty t'a qjellëson,
Në djellë, mëndjen që t'a djellëson,
Në botë, mëndjen që t'a botëson"

Se poeti ka përdorur intuitën e vërejmë e vërejmë në çdo varg"që mendjen ty", do të kuptojmë se intuita është më shumë intelektuale sesa ndiesore (sensuale). Intuita është zbuluese dhe thelbi i vërtetë i vet figurave të përjetësisë. E gjithë njohja e thellë e përjetësisë i ka rrënjët te kuptimi intuitiv i gjërave. Në kuptimin gjuhësor, bashkim do të thotë: tubim, mbledhje apo shumësi, kurse përjashtësi e ka kuptimin e nënbashkësisë.

"Në shteg-bashkimi, që ti s'di sesi,
Bashkohesh brënda me përjashtësi,
Bashkohesh jashta me përmbrendësi,
Bashkohesh-ritesh-me-përjetësi."

Në këtë "shteg-bashkimi", poeti përjeton se vetja dhe krijimi poetik ekziston vetëm me ndihmën e përjetësisë. Në këtë gjendje bëhet një harmonizim bashkues i universit duke i konsideruar si reflektime dhe shenja të qenësisë së përjetësisë.

Pra, shikimi i gjithësisë me këto sy dhe jetësimi i përjetësisë, për poetin, është thelbi i kësaj gjendje intuitive shpirtërore. "Bashkimi brënda me përjashtësi" dhe "Bashkimi jashta me përmbrendësi," e ka kuptimin e gjithësisë-universit, që është për poetin një libër i bashkuar me përjashtësi objektive-materiale dhe përmbrendësi subjektive-metafizike të përbërë nga përjetësia, të gjitha këto janë simbole në kuptim të përjetësisë. Shikimi i të përgjithshmes në të veçantën për poetin është mendim themelor intuitiv, sepse poeti normal njeherë veçanti dhe vetëm të veçantën si të tillë.

Lasgush Poradeci krijimtarinë poetike e sheh si vepër përjetësore, e kupton se simbolet e ndryshme brenda universit paraqiten si pasojë e reflektimit të llojllojshëm të përjetësisë dhe këtë llojllojshmëri e kupton si njëshmëri vlerash të përjetshme. Njohja poetike e gjërave i përket poetit, kurse bashkimi merret me personalitetin e poetit. Për të qenë më i qartë do të themi se ç'ështëjtet e përfituara me veprat e poetit janë ndarja, ndërsa ajo që vjen prej përjetësisë quhet bashkim. Pra, bashkimi i poetit me përjetësinë do d.m.th. ndarja prej veprave jashtë përjetësisë, dhe kjo ndarje prej të tjerëve, është bashkim me përjetësinë. Verifikimi i krijimtarisë poetike është derë e ndarjes, ndërsa verifikimi i përjetësisë është vlerë, cilësi dhe bashkim. Për poetin dhe për të gjithë ne, koha është e vazhdueshme:

"Jam sot si vjet,/jam mot si përgjithnjë", sepse ajo ka dalë nga përjetësia dhe do të kthehet përsëri aty, "tërë universi don të kthehet në atë burimin e përjetshëm që është jokohore, as i mëparshëm, por që është jashtë kohe"(Jorgo Luis Borges, Pavdekësia dhe ligjërata të tjera, Aafërdita, Tiranë, 2000.

SINESTEZIONI

Tiparet e stilit simbolist fillojnë me Sh. Bodler-in, i cili ka dhënë kontribut të madh në zgjerimin e mundësive shprehëse të gjuhës poetike



Sherif SELIMI

Simboli ka veti të pranojë në vete shumë drejtime të relacioneve semantike, posedon shprehje teorike të pakufishme dhe komplekse. Kështu, në gjuhë jepet mundësia e kreativitetit. Aftësia potenciale me të cilën krijimtaria brenda në gjuhë hap hapësirë të re konceptuale, duke krijuar figura, ide, ndjenja dhe paragjykime të reja, na sjell te "loja me fjalë magjike". Që nga kohët më të hershme ekzistonte mendimi për lidhjen e poezisë me magjinë. Poeti nuk është magjistar, por fuqia e fjalës, me të cilën ai sundon me plot vetëbesim, kontribuon për pasqyrimin e një drite të tillë, si dhe bën perceptim të poezisë në kufijtë e çudisë.

Tiparet e stilit simbolist fillojnë me Sh. Bodler-in, i cili ka dhënë kontribut të madh në zgjerimin e mundësive shprehëse të gjuhës poetike. Pastaj, vazhdon me Rembo-në dhe Malarme-në, të cilët i kanë dhënë një trajtim të ri cilësor plasticitetit dhe muzikalitetit të poezisë në aspektin e gjuhës. Ato elemente do të jenë aktuale, do të qëndrojnë deri më sot. Teza e përmendur e përjeton vërtetimin e vet, mes tjerash, edhe nëpër praktikën poetike të autorëve tanë bashkëkohorë.

Kështu, në fazën e modernizimit të

mundësive të shprehura të gjuhës poetike në letërsinë tonë vërehet shpesh përdorimi i mjetit kryesor stilistik të simbolizmit të poezisë, sinestezionit. Sinestezioni, (1986,728-728) që nuk është term ekskluziv letrar, shënon përzjerje të shfaqjeve ose lidhje të dukurive të fushave të ndryshme stilistike. Klasifikimi i tij ka të bëjë me: vizualen, auditiven, olfaktorin, gustativen, taktilen dhe psikiken. Në letërsinë teorike quhet edhe "audition coloree" ose "dëgjim i ngjyrosur", ai e ka bazën psikike dhe biologjike, por, jo rrallë, është kontestuar kah shenja për gjendje patologjike të shpirtit. Sinestezion shembullor kemi tanimë në bibël, pastaj te Homeri etj. Sinestezioni do të përdoret në realitetin gjuhësor dhe poetik të simbolistëve dhe bëhet shenjë e të folurit poetik, si dhe element i poetikës së poezisë gjithëpërfshirëse moderne, evropiane.

Sinestezioni i takon grupit të figurave semantike, për të cilat është ndryshim karakteristik i domethënies themelore të rëndomtë të disa fjalëve të caktuara. Poeti modern ec nëpër rrugën e matematikanit që lidhet me numrat joracionalë dhe transcendentë që, sipas operacioneve të veçanta, e konstruktin botën imagjinare të simboleve matematikore, të cilët e kanë logjikën e tyre të brendshme.

Sinestezioni e arrin funksionin referencial të gjuhës poetike dhe e rrënon logjikën kauzale të botës reale dhe mendimin racional: "Syri na mashtron duke ia veshur lules cilësitë e rrezes së diellit. Veshi na mashtron duke ia veshur valëzimin e zërit të ziles që bie. Gjithë vetëdija jonë na mashtron duke i bartur cilësitë e veta, kushtet e veprim-it të vet ndaj objekteve të jashtme" (1983,8-11), thekson udhëheqësi i simbolizmit rus Valerij Brusov. Me këtë mendim korrespondojnë vargjet e Rahman Dedajt në poezinë:

S'KA KUPTIM TË KUPTOSH ÇDO GJË

Çdo gjë që ka pritur
Nuk ka pritur vetëm

Ajo që të duket krejt afër
Është largësia që s'e kupton
Mashtrimi është gjë e zakonshme
Arrin para dhe prapa teje
Emër ka vetëm ajo që përgjigjet

Frika flet me frikën
Duke nxjerrë gjuhën

S'do mend ka gjëra qesharake
Që fillojnë e mbrojnë gabimisht
Ndonëse çdo gjë s'rrjedh si uji
Me ty as përtej teje
Ku vazhdon ecjen e ngadalësuar

Tekefundit s'ka kuptim
Të kuptosh çdo gjë të kuptuar

Interesi për këtë veprim intensifikohet në procesin e modernizimit të mjeteve ekspresive. Këto elemente i hasim edhe në poezinë moderne shqipe. Impulset më të rëndësishme simboliste në poezinë shqipe janë: vizuelet, auditivet dhe sinestezioni elifaktorik, si dhe kombinimet dhe variacionet e tyre të ndërsjella. Është e qartë, kur dihet se vizualiteti dhe muzikaliteti i vargut posaçërisht janë fascinuar nga shqisa për nuhatje, nga ana tjetër, për shkak të natyrës jomateriale të sensacioneve që i ofron ajo. Shembuj të tillë në të cilët zëri paraqet zë artistik vizual (auditivo-vizual) ose të fotografisë së paraqitur si fotografi tingëllore (vizuale-auditivo) dhe si "aromat posedojnë ngjyrë, gjegjësisht cilësi zërore (auditivo-olfaktorike, vizuale-sinestezone olfaktorike), ka edhe në poezinë shqiptare: "zë me ngjyrë qiellor, fjalë e ëmbël", "këngë me aromë" (Asdreni), "fjalë më shumë të ëmbël", "Aromë e flaktë", "Këngë me vrer, vrer të zi" (L. Poradeci), "Fjala jote pelin", "Fjalë e kuqe si gjaku", "Këngë më zjarr", "Mendim i bardhë", "Fjalë e kaltër", "Fjala u dogj nga etja", "Fjala nuk u errësua", "Dhimbje e kaltër", "Zëri gjelbërohet" (Azem Shkreli), "Kënga e gjelbër", "Kënga që ka aromë buke", "Përralla e kuqe", "Kënga që merr ngjyrë gjaku", "Mendime të gjelbra", "Fryjnë erëra të kuqe", "Gjuha me ngjyrë bari", "Ylberi i këngës" (Rahman Dedaj), "Ëndrra të zjarrta", "Këngë dhe ngjyra", "Erëra të gjelbra", "Gjak i gjelbër", "Ëndrra të gjelbra", "Shi i gjelbër", "Diell i gjelbër", "Diell i gjelbër", "Batica e gjelbër", "Oqeani i gjelbër", "Këngët e gjelbra", "Këngë me ngjyrë gjumi" (Adem Gajtani). Varësisht nga ajo se cilat përshtypje shqisore marrin pjesë në kontaktin sinestezist, është praktikuar në praktikën poetike, duke filluar nga fillestarët e parë të lirikës moderne shqiptare (Asdreni, Poradeci) e deri te një plejadë e poetëve bashkëkohorë shqiptarë (Shkreli, Dedaj, Gajtani etj.) Sinestezioni kontribuon për rinovim, freski të shprehjes poetike. Sipas studuesve të këtij fenomeni poetik G. Misho, H. Fridrih, R. Jakobson, S. Koleviq, Z. Kravar etj., duke i fshirë kufijtë e perceptimit shqisor, sinestezioni jo vetëm që nuk e përfill përjetimin fragmentar shqisor të botës së paraqitur, por në emër të disa mundësive të pandiera të shpirtit njerëzor, kthehet në shkallën zero të njohurisë, në të cilën gjërat bëhen kategori esenciale dhe produkte të një lloji të caktuar të receptimit sensorik. Fjala poetike njëkohësisht fascinon dhe huton. Pakuptueshmërinë dhe fascinimin në lirikën moderne H. Fridrih e emërton "tensioni disonant", i cili, po ashtu, ka karakter të më shumë kuptimeve dhe pasurisë së nuancuar të pasqyrës gjuhësore poetike.

RRËFIM I SHKURTËR PËR VETEN

Emil CIORAN

Kam dëshirë të shkruaj veçse kur jam në një gjendje shpërthyes, kur jam nën ethe, apo kur ha thonjtë me dhëmbë, kur jam nën trysinë e një tensioni nervor, kur çudia shndërrohet në frenezë, dhe, në vend të jap goditje me grushte, apo shuplaka, mërmëris të shara. Fillon zakonisht kështu: një drithërimë e dobët që bëhet gjithnjë e më e fortë, sak si gjendja pas një fyerjeje, të cilën e ke mbajtur vath në vesh. Të shprehurit nënkupton një replikë, apo një veprim agresiv të vonuar: shkruaj me qëllim që të mos arrij tek të vepruarit, për të shmangur një krizë. Të shprehurit është lehtësim, revansh i tërthortë I atij që s'mund të hajë turpin me bukë, ndaj rebelohet me fjalë ndaj të ngjashmëve dhe ndaj vetes. Zemërimi është më shumë një impuls letrar, sesa moral; në të vërtetë ai është burim i frymëzimit. Po urtësia? Është pikërisht e kundërta. Ajo shkatërron brenda nesh të gjitha impulsset e mira; është sabotuesja që na poshtëron, që na paralizon, që përgjon të çmendurin

brenda nesh, me qëllim që ta qetësojë, ta komprometojë dh eta çnderojë. Po frymëzimi? Një çekuilibër i befasishtëm, një ëndje e madhe për t'u pohuar, apo për t'u shkatërruar. S'kam shkruar qoftë edhe një rresht të vetëm me temperaturë normale. Dhe, ndërkaq, për vite të tëra e kam ffilluar veten si të vetmin individ pa cene. Kjo krenari ka qenë diçka e dobishme për mua: më ka lejuar ta nxij letrën e bardhë. Praktikisht nuk shkruaj kur qetësohet deliri, kur bëhem preja e një modestie të rrezikshme, vdekjeprurëse për atë ferment nga i cili rrjedh intuita dhe të vërtetat. Nuk mund të shkruaj veçse kur, pasi më braktis papritur sensi i qesharakes, e çmoj veten fillim dhe fund...


Të shkruarit është një provokim, një këndvështrim fatmirësisht i rremë i realitetit, i cili na vendos përsipër asaj çfarë është, dhe asaj çfarë duhet të jetë. Të rivalizojë Zotin madje ta tejkalojë atë, thjesht përmes virtytit të gjuhës: e tillë është orvatja heroike e shkrimtarit, specie ambige, i molisur dhe i dalldisur pas vetes, që, duke e braktisur gjendjen e tij të

natyrshme, i ka dhënë vetes të drejtën të përjetojë një marramendje sipërane, trallisëse, ndonjëherë të neveritshme. S'ka gjë më mjerane sesa fjala, por bash prej saj ia ngjitet gjer te ndjeshmëria e lumturisë, gjer te prëjtja e skajme, ku është krejtësisht i vetëm, pa ndjesinë më të vogël të shtypjes. Supremja mbërrihet përmes fjalës, përmes vetë këtij simboli, të brishtësisë. Për çudi, mund të mbërrihet gjithashtu edhe përmes ironisë, me kushtin që kjo, duke e çuar gjer në ekstrem punën e saj rrëmimtare, t'i shkaktojë rrëqethje një zoti që punon së prapthi. Fjalët si mjete të një ekstaze të rikthyer... Gjithçka që është me të vërtetë intensive merr pjesë si në parajsë, ashtu edhe në ferr, me këtë ndryshim: të parën mund ta marrim me mend, teksa, të dytin kemi gjasën ta kundrojmë, apo, më mirë, ta ndjejmë. Ekziston një përparësi akoma edhe më e madhe, e cila është monopol i shkrimtari t'i heqë qafe rreziqet e veta. Pa të drejtën për të nxirë faqe, as vetë s'e di çfarë do të kisha bërë. Të shkruash do të thotë të zhbësh brerjet e ndërgegjes dhe mllefet, do të thotë

t'i vjellësh sekretet e tyre. Shkrimtari është një i lajthitur që përdor trillimet e fjalëve për t'u mjekuar. Mbi sa vështirësi mbi sa sulme të pamëshirshme kam trimfuar sajë këtyre melhemeve delikate


Të shkruarit është një ves që nuk mund ta lësh. Në të vërtetë, shkruaj gjithnjë e më pak, dhe pa dyshim do të vijë koha që s'do të shkruaj më fare, ngaqë s'do të më japë më asnjë kënaqësi kjo betejë me të tjerët dhe me veten.

Kur sulmojmë dikën qoftë ky dhe një njeri i zakonshëm, përjetojmë ndjesinë e plotësisë, shoqëruar me një grimë qibër. Një fenomen edhe më i çuditshëm akoma: ndjesia e superioritetit, kur përshkruajmë një figurë që e admirojmë. Mu në mes të një fjalie, ah, me çfarë lehtësie besojmë se jemi qendra e botës! Të shkruarit dhe të admiruarit nuk shkojnë së bashku: na pëlqen apo jo, të flasësh për Zotin, do të thotë ta kundrosh atë nga lart. Të shkruarit është hakmarrja e krijesës, dhe përgjigja e saj për një Krijim të drejtës. (Nga libri "Sprovë admirimesh"; përkthyer nga frengjishtja, Balil Gjini)



KONTRIBUT PËR GJEOGRAFINË HISTORIKE TË POPULLIT SHQIPTAR

Peter Bartl-Injac Zamputi, Vincenzo Zmajevich- Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë (1702-1703), Botoi: Albanisches Institut - Faik Konica, St. Gallen - Prishtinë, 2022



Dr. Nail DRAGA

Në jetën e një populli nuk janë të rrallë rastet ku disa personalitete kanë luajtur rol të rëndësishëm në ngjarje të ndryshme, të cilat janë bërë pjesë e historisë kombëtare. Në këtë gamë të çështjeve të shqiptarët në të kaluarën vend nderi zënë klerikët e nderuar si Buzuku, Bogdani, Bardhi, Budi etj., ndërsa këtyre iu shtohet edhe teologu Vincenc Zmajeviqi i cili veçohet me dy kontribute me peshë të veçantë. E para është roli i tij në organizimin e Kuvendit të Arbrit (14 janar 1703) dhe e dyta, ka të bëjë në emigrimin dhe vendosjen e shqiptarëve nga krahina e Krajës dhe e Shestani në Zarë të Dalmacisë në vitin 1726. Por, ky personalitet i nderuar në sajë të angazhimit jo vetëm teologjik ka mbledhur të dhëna me interes për shqiptarët që i ka shkruar në veprën *Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë (1702-1703)* e cila për një kohë të gjatë ka qenë e panjohur për opinionin e gjerë, por në sajë të angazhimit të përbashkët në mes Institutit Shqiptar në St. Gallen në Zvicër dhe SHB "Faik Konica" në Prishtinë, në vjen e botuar në shqip në vitin 2022.

Në sajë të informacionit që disponojmë, Relacioni i ipeshkvit Vincenc Zmajeviqit i vitit 1702/1703 është vepër e tre autorëve: Vincenc Zmajeviq, Peter Bartl dhe Injac Zamputi. Zmajeviqi e ka shkruar këtë relacion nga vizita apostolike në ipeshkvijtë e Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë më 1702/1703. Këtë relacion e ka botuar italisht (versioni i arkivit të Vatikanit) Peter Bartl më 1979 në librin "Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte Im 17. Und 18. Jahrhundert" fq. 1-186, përcjellë me shpjegime e shënime nga vet Bartl-i. Ndërsa në shqip është përkthyer nga Injac Zamputi më 1988, që ishte përkthim i pabotuar deri tani.

Autoritet i kohës së tij

Vincenc Zmajeviqi ka lindur në Perast (Mali i Zi i sotëm) më 23. 12. 1670 në një familje kroate e njohur në historinë e rajonit dhe më gjerë. Me ndihmën e xhaxhai i tij, Andrija Zmajeviqi, i cili ishte ipeshkvë i Tivarit (1671- 1694), dërgohet në "Collegium Urbanum" në Romë, ku përfundon studimet në filozofi e teologji, ku edhe doktoroi më 30. 03. 1695. Pas shugurimit meshtarak, më

1696 kthehet në vendlindje dhe emërohet famullitar në Perast. Më 1701 papa Klementi XI e emëroi ipeshkvë të Tivarit me dekretin: "Vicentius Zmajevich, archiep. Antibarensis 8 Julii 1702 deput. visit. apost. ecclesiarum et missionum prov. Epiri seu Albaniae iuxta decr. S. Congr. Prop. 13 Iun. 1702 emanatum et a S.S. 19 Iun. 1702 approbatum". Vincenc Zmajeviqi ishte ipeshkvë i Tivarit deri sa u emërua ipeshkvë i Zarës në Kroaci, më 1713, ku edhe vdiq më 11.09.1745.

Pas emërimit të tij ipeshkvë i Tivarit më 1701, Papa Klementi XI (Giovanni Francesco Albani) emëroi Zmajeviqin Vizitator Apostolik në Shqipëri, Serbi, Maqedoni e Bullgari, dhe këtë vizitë e filloi në shtator të vitit 1702 e që zgjati deri në shkurt 1703. Pasi Zmajeviqi kishte vizituar si i dërguar i Vatikanit ipeshkvit në Shqipëri, Maqedoni, Serbi e Bullgari, kishte parë gjendjen e mjerueshme të katolikëve shqiptarë, jo vetëm materiale por edhe organizative, strukturore nën Perandorinë Osmane. Një situatë e tillë aspak e favorshme ndikoj që ai të ndërmarë diçka konkrete për Kishën Katolike në trojet shqiptare. Kështu falë Zmajeviqit u thirr dhe u organizua Kuvendi i Arbrit i cili u mbajt më 14 dhe 15 janar 1703 në Mërçi në afërsi të Lezhës, ku u tubuan ipeshkvijtë e klerikët katolikë, apo më mirë të themi, përfaqësuesit kishtarë shqiptarë për të diskutuar dhe vendosur rregulla për jetën kishtarë në trojet shqiptare.

Gjatë historisë kishtarë, organizime ipeshkvore apo ndëriveshkvore ka pasur edhe më parë, por "Kuvendi i Arbrit" ishte me përmasa të mëdha, pasi për këtë ishte informuar mirë Papa Klementi XI dhe dokumentet e botuar pas Kuvendit ishin të shumta, latinisht e pastaj edhe shqip, me interes shumëplanësh studimi, si kishtarë, historike, gjuhësore, gjeografike e etnografike, duke qenë i rëndësishëm për historinë e popullit shqiptar. Relacioni i vitit 1702/03 i Zmajeviqit nuk është me interes vetëm për historianët e shekullit XVII. Përmbajtja e tij do të mund të përkthehet në pika të shkurtra kështu. Faqet e para ia kushton gjendjes jo vetëm historike shqiptare, por edhe asaj ekonomike, pozicionit gjeografik, dioqezave në trojet shqiptare, gjendjes së mjerueshme të të krishterëve nën sundimin e Perandorisë Osmane, por edhe kritikën ndaj klerit katolik nuk mungojnë. Në këtë pjesë, Zmajeviqi shkruan se duhet thirrur një koncil provincial shqiptar, çka edhe bëri më 1703 (Kuvendi i Arbrit).

Përshkrimet e Zmajeviqit në këtë relacion janë detaje për kohën, jo vetëm për jetën e besimtarëve apo të klerikëve, për hapësirën gjeografike që ai viziton, për shkatërrimin e kishave, tjetërsimet nëpër kisha, por jep edhe numra të saktë të besimtarëve katolikë nëpër famulli. Në këtë kohë, siç dihet, islamizimi kishte shtrirë rrënjët jo pak në popullin shqiptar dhe jeta ishte tejet e vështirë jo vetëm për të krishterët, por edhe për ata që ishin islamizuar. Kishte edhe të tillë që, në brendi mbaheshin të krishterë, kurse jashtë si myslimanë.

Relacioni trajton, me nga një kapitull të veçantë, dioqezat që ai vizitonte e ku jetonin katolikët, si ato të: Tivarit, Shkodrës, Pultit, Sapës, Lezhës, Administratën e Durrësit, Budues, gjendjen e kishave të Serbisë dhe Administratën e

Shkupit, gjendjen e të krishterëve në Bullgari. Jep po ashtu edhe ide për dalje nga kjo gjendje e mjerueshme, nevojat e misionarëve françeskanë etj. Kemi të bëjmë me një relacion të detajuar nga një individ i përgatitur jo vetëm në aspektin teologjik, që ishte model për kohën kur është shkruar, por e them pa hezitim se mund të shërbejë model edhe për kohën tonë, duke ofruar të dhëna me interes shumëdimensional.

Vendbanime të shpopulluara

Duke analizuar këtë botim ku ofrohen të dhëna për një numër të konsideruar të vendbanimeve, unë me këtë rast jam përcaktuar për disa vendbanime të cilat sot janë në kuadër të Malit të Zi. Pikërisht duke marrë parasysh të dhënat për vendbanimet e prezantuara në kuadër të famullive të tyre, del qartë se në ditët tona pas me shumë se tre shekujve disa vendbanime nuk ekzistojnë më. Ata janë shpopulluar për shkaqe të ndryshme të kohës goftë në sajë të emigrimit, sëmundjeve të ndryshme apo çështje të tjera sociale dhe si të tilla i takojnë gjeografisë historike. Në këtë aspekt na ndihmojnë edhe hartat e publikuara për kohën përkatëse për të deshifruar më saktë vendndodhjen e tyre.

Shasi-famullia kryesore në Anë të Malit

Me këtë rast dua të cek disa të dhëna që kanë të bëjnë me famullitë në Anë të Malit, sepse kemi të bëjmë me disa të dhëna me interes gjeografik, historik e etnografik. Kështu për famullia kryesore e Anës së Malit është ajo e Shasit e cila përbëhet nga 9 vendbanime (Brija, Shasi, Milla, Krytha, Kllezna, Brajsha, Selita, Suma dhe Bukmira) të cilët gjithsej kanë 114 shtëpi me 923 banorë, ndërsa në aspektin fetarë ishin: 69 shtëpi katolike dhe 602 banorë, 41 shtëpi myslimane me 290 banorë si dhe 4 shtëpi ortodokse me 31 banorë.

Nga këto vendbanime më së shumti shtëpi katolike kishte Milla 18 shtëpi me 171 banorë, duke pasuar nga Brija e Kllezna. Ndonëse ishte seli e famullisë Shasi kishte 1 shtëpi katolike me 3 banorë, ndërsa kishte 12 shtëpi myslimane me 90 banorë, dëshmi e procesit të islamizimit të popullsisë shqiptare, duke filluar nga viti 1571, nga koha kur Shasi është okupuar e shkatërruar nga Perandoria Osmane. Ndonëse para okupimit Shasi ishte ipeshkvi, nga ajo traditë kishtarë tash kishte statusin e famullisë, me numër minimal të banorëve.

Në relacion V. Zmajeviqi për Shasin ofron të dhëna për të kaluarën e tij duke cekur disa kisha me emër, të cilat në kohën tonë tash dihet me emër vetëm për dy prej tyre (Katedralja e Shën Gjonit Brenda qytetit dhe ajo e Shën Mrisë, jashtë mureve të qytetit).

Brija dhe Bukmira i takojnë gjeografisë historike

Nga numri i përgjithshëm të vendbanimeve të cilat prezantohen në këtë botim dy vendbanime janë të diskutueshme. Fjala është për dy vendbanime në Anë të Malit, e ata janë BRIJA, e cila gjendej në pjesën veriore të liqenit të Shasit, ku sot gjendet vendbanimi me emrin Kllezna Poshtë. Në

vitin 1703 kishte 11 shtëpi katolike me 115 banorë, ndërsa të fesë islame ishin 3 shtëpi me 25 banorë. Por, nga të dhënat e mëvonshme ky vendbanim nuk figuron, sepse sipas një informacioni që disponoj në vitin 1756 popullsia e 42 shtëpive e tëra ka emigruar në Itali. Nuk ka të dhëna se kush ishte motivi i emigrimit kolektiv, ku supozohet sëmundja e kohës apo ndonjë motiv tjetër social. Por, nga ajo kohë e më pas këtu është vendosur një popullsi e ardhur nga Mirdita, dhe Shkreli që është e pranishme edhe në ditët tona. Nga ajo kohë humbi emri i mëparshëm BRIJA, ku si dëshmi janë gërmadhat e shtëpive të asaj kohe, ndërsa me banorët e rinj vendbanimi quhet Kllezna Poshtë, në analogji me vendbanimin e njëjtë i cili quhet Klleznë, e më pas Kllezna e Sipërme (Naltë).

Nga këtë aspekt kemi edhe vendbanimin **BUKMIRA**, në afërsi të Shasit të sotëm, e cila kishte 4 shtëpi katolike me 41 banorë dhe 2 shtëpi të fesë islame me 13 banorë. Kemi të bëjmë me një vendbanim me pozitë të përshatshme gjeografike me resurse natyrore që sipas të dhënave është vendbanim i vjetër dhe i banuar. Në atë kohë këtu behët fjalë për kishën Shën Pelegrinit, për të cilën sot nuk dihet. Por, nga ajo kohë e më pas nuk ekzistojnë të dhëna se popullsia është rritur, por e kundërta duke mbetur pas Shasit. Mbetet të hulumtohet për ish popullsinë e Bukmirës dhe numrin e tyre me pas, sepse ka mbetur pa banorë. I cekëm këto dy vendbanime sepse me pas ata nuk figurojnë, sepse popullsia për shkaqe të ndryshme ka emigruar, që mbeten çështje për hulumtim, ku si të tilla këto vendbanime i takojnë gjeografisë historike.

Nuk ka dilemë se një çështje e tillë ekziston edhe në dioqezat tjera shqiptare ku iu takon studiuesve të japin kontributin në hulumtimin e tyre në terren, por edhe të emërtimi, sepse disa kanë evoluar për nga forma që paraqet vështirësi në identifikimin e tyre. Nga ana tjetër duhet cekur se V. Zmajeviqi përveç përkatësisë fetare katolike e islame të popullsisë ofron të dhëna edhe për përkatësinë fetare ortodokse të vendbanimeve shqiptare. Këtu mendoj për disa vendbanime në famullitë në Anë të Malit e në Krajë e cila më pas është eliminuar duke kaluar në atë islame, që dëshmohet me pas në sajë të dhënave në terren në këto mjedise. Ndërsa të dhënat në këtë relacion për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kelmendi në vitin 1700 të rreth 250 familje për në Peshter, Novi Pazar, Rozhajë etj., të cilët si të përkatësisë fetare katolike në mungesë të meshtarëve rrezikonin të asimiloheshin në mysliman apo ortodoks sllavë, dukuri e cila më vonë ndodhi në realitet, duke humbur identitetin kombëtar.

Përfundimisht analiza e vendbanimeve në kuadër të dioqezave, përkatësisht të famullive përkatëse nga ajo kohë e deri në ditët tona ofron mundësi për analiza të ndryshme. Pikërisht në këtë aspekt ky relacion do të nxitë kureshtjen e lexuesve, sepse kemi të bëjmë me një botim i cili i ka munguar literaturës shqipe. Ndërsa i botuar në prag të vitit jubilar të Kuvendit të Arbrit është një dhuratë jo vetëm për studiuesit e profileve shkencore por edhe për opinion e gjerë.

NUMRI I ARDHSHEM ME 5 MARS

HEJZA

20 SHKURT, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000